



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR DHE
PËRPUTHSHMËRIENË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t QARKU
KUKËS.**

"Mbi auditimin e pasqyrave financiare vjetore të institucionit".

Auditimi u ushtrua në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 543/1, dt. 07.05.2018, ndryshuar me nr. 695, datë 07.06.2018 .

Auditimi është kryer nga:

1. Artan Mirashi, përgjegjës grupi;
2. Alfred Cako;
3. Xhovan Domi;
4. Rezart Golemaj;
5. Besmir Pajaj

Auditimi ka filluar më 14.05.2018

Auditimi ka përfunduar më 22.06.2018

Korrik 2018

**PERMBAJTJA****Faqe**

I.	Përmbledhje.....	3-9
	a. Hyrje	
	b. Informacion i Përgjithshëm	
	c. Objektivat dhe qëllimi	
	d. Identifikimi i çështjes	
	e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	f. Përgjegjësitë e audituesve	
	g. Kriteret e Vlerësimit	
	h. Opinioni i Audituesit	
II.	Përshkrimi i auditimit.....	9-67
A.	MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMI I MËPARSHËM	9
B.	AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE.....	9-41
B.1.	Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Nxjerrja e llogarive vjetore (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i aseteve dhe Aktiveve....	9-28
B.2.	Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit	28-33
B.3.	Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (pagat dhe shpërblimet etj).....	33-37
B.4.	Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.....	37-41
C.	ZBATIMI I PROCEDURAVE LIGJORE NË LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE.....	41-67
D.	GJETJET NGA AUDITIMI, IMPAKTI TE PASQYRAT FINANCIARE DHE REKOMANDIMET PËRKATËSE.....	67-74
E.	ANEKSE	74-84
E.1.	QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.	
E.2.	LLOJET E OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.	
E.3.	STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT	
E.4.	PARIMET THEMELORE TË AUDITIMIT FINANCIAR	
E.5.	LISTA E OBJEKTEVE TË SKUALIFIKUAR	
E.6.	VETË DEKLARIMET	
E.7.	SIPËRFAQE TË ZAPTUARA PJESË TË PARCELAVE NDËRTIMORE TË LEGALIZUARA.	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

PËRMBLEDHJE

Hyrje:

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës, në bazë të programit të auditimit nr. 543/1, datë 07.05.2018 i ndryshuar me nr.695, datë 07.06.2018 duke i kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, dhënia e opinionit (viti 2016) për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit. Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së raportimit financiar të aktivitetit ekonomik të mbyllur më datë 31.12.2017.

Informacion i përgjithshëm:

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.

Funksionin e saj e kryen në zbatim të ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Struktura organizative e miratuar me Urdhër të Kryeministrit përkatësisht: për vitin 2015 me Urdhër nr.111, datë 06.08.2015 të Kryeministrit "Miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe Drejtoritë në varësi të saj e ndryshuar; për vitin 2016 me urdhrin nr. 58, datë 05.04.2016 dhe me shkresën nr.6974/3 prot, datë 24.01.2017 për vitin 2017, në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës është: Drejtor, Sektori i Legalizimit Planifikimit Urban Kukës, Sektori i Hartografisë Përpunimit Informacionit, Sektori i Çështjeve të Pronësisë, dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Nga auditimi i procedurave të legalizimit dhe aktivitetit financiar të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës për periudhën objekt auditimi u konstatua shkelje të procedurave të legalizimit konkretisht: -nëmarrjen e vendimeve "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal" ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" nenin 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" "vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë" me pasojë duke shkaktuar një të ardhur të munguar në buxhetin shtetit në vlerën 29,919,892 lekë;

Objekti i veprimtarisë së DRA, Qarku Kukës është:

Misioni i Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës, si varësi Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t. në zbatim të ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

-Legalizimin e objekteve pa leje dhe shtesave vertikale dhe horizontale në objektet me leje ndërtimi".

-Kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje, sipas përcaktimeve të këtij ligji në favor të zaptuesit të pronës.

-Urbanizimin e zonave, blloqeve informale e të ndërtimeve informale, si dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial dhe infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e jetesës.

-Procedurat për realizimin e legalizimit të ndërtimeve informale/objekteve dhe shtesa informale në objektet me leje ndërtimi si dhe ngritjen e funksionimit e strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre.

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Objektivat e auditimit:

“Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, të dobishëm për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish të cilët nuk kërkojnë raporte të veçanta për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion”¹.

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Baza Ligjore:

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

-ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”

-INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”; INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

-Në praktikat më të mira të fushës si: (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve IFAC, Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve),

-ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.07.2007, ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008, ligjin nr. 10099, datë 19.03.2009, ligjin nr. 10169, datë 22.10.2009 ligjin nr. 10219, datë 04.02.2010, ligjin nr. 141/2013, datë 02.05.2013 dhe ligjin nr. 50/2014, datë 15.05.2014, ligjin 62/2015, datë 11.06.2015 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”;

Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Vendim i KM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”;

-Vendimi i KM nr. 488, datë 22.07.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

-Vendimi i KM nr. 589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale"; etj.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:

Drejtori z. Vladimir Spahiu, Përgjegjësja i Sektorit të Buxhetit dhe Financës z. Nashide Shala, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar (SNK dhe SKK) dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Gjithashtu drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Drejtorisë Rajonale për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Drejtorisë Rajonale.

Drejtori dhe Përgjegjësja i Sektorit të Buxhetit dhe Financës janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (*apo në përputhje*) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm që është relevant në entitet, në mënyrë që të programonin procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Drejtorisë.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesive dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, observacioneve të paraqitura nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Kukës u përgatit Raporti i Auditimit.

**Baza për Opinionin**

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet, KLSH është e pavarur nga Drejtoria Rajonale dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:

Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës, është realizuar në mbështetje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK), Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara si edhe shoqërohen me relacion shpjegues. (*pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare*).

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2017 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej **2%**, vlerën **419,480** lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. (*Aneksi I*)

Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në Drejtori nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin tërë veprimtarinë e njësive ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike nuk mund ta dijë ku mundet të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësive është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Ngjarje pas bilancit:

Në zbatim të urdhrin 3, datë 20.04.2015, Urdhrit nr 44, datë 30.12.2016 dhe Urdhrit nr. 55, datë 20.11.2017 "*Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin jashtë përdorim*", sipas relacioneve të komisionit kanë dalë jashtë përdorimit objekte në shumën prej 382,092 lekë e realizuar deri 20.04.2015 e cila i takon aktiveve të vitit 2015, objekte në shumën prej 60,577 lekë e realizuar deri 30.12.2016 e cila i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

takon aktiveve të vitit 2016, dhe objekte në shumën prej 325,868 lekë e realizuar deri 31.12.2017, e cila i takon aktiveve të vitit 2017

Ngjarjet e mësipërme pas periudhës raportuese, është një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese (*Inventarizimi për vitet*) për të cilën duhet të bëheshin rregullime në vlerë. Drejtoria ka rregulluar shumën e mësipërme në pasqyrat e saj financiare, duke përfshirë edhe dhënien e informacioneve përkatëse shpjeguese, për pasqyrimin e ngjarjes rregulluese pas përfundimit të periudhës raportuese.

- **Konfirmimet nga të tretët:**

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakordura*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- **Kontabiliteti:**

Në nenin 10 të Ligjit nr. 9228, dt. 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" përcaktohen parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. (SKK 1) i përmirësuar. Mos aplikimi i rregullave kontabël mbi bazën e parimit të kontabilitetit pra mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraqen ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe regjistrohen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t'u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.

Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. **Kontrolli aritmetik.**

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohem nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.**

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3. **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakorduar*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës në mbështetje të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" dhe (ISSAI 1700, dhe 4200¹) për të cilën do të japim opinion:

Audituesit e KLSH-së, nëpërmjet auditimit të realizuar në Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, Raportimit Financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës në marrjen e vendimeve "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal", ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, nenin 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" – "*vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi*", si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" -Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet – "*c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive të Qarkut Kukës, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi, duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën **29,919,892 lekë**.*

*Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në subjektin Drejtoria Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**.*

¹ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës për vitin ushtrimor përfunduar më 31.12.2017 të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se; pozicioni financiar, performanca, ndryshimet në kapital, flukset e mjeteve monetare janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit, SNK dhe SKK të përmirësuara. dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

*“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700² shprehim një **opinion të pakualifikuar**.*

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës më datën 31 dhjetor 2017 performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, në Shqipëri.

PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

A. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMI I MËPARSHËM.

Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës nuk ka auditime nga KLSH-ja për periudhat e mëparshme.

B. AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE.

B.1.Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Nxjerrja e llogarive vjetore (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i aseteve dhe Aktiveve

B.1.1. Auditimi i pasqyrave financiare viti 2015.

1. Nga verifikimi formal i pasqyrave financiare për vitin 2015 rezultoi se janë:

- bilanci, - pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, - pasqyra e ndryshimeve në kapital, - pasqyra e fluksit të parasë si dhe aneksi për shënimet shpjeguese.

Hartimi i pasqyrave financiare bazohet në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”), të përcaktuara në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Pasqyrat financiare të vitit 2015 janë miratuar me datë 23.02.2016 si dhe është shoqëruar me relacion nga Sektorit i Buxhetit dhe Financës për “Raporti mbi realizimin e treguesve ekonomik financiar dhe miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2015”.

Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të ALUIZNI-t Kukës në fund të periudhës kontabël dt. 31.12.2015.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë:

- Aktivet, Detyrimet, Kapitali.

²Objekti i auditimit është të formulohet një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Klasifikimi i elementeve të mësipërme në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sigurtë të situatës financiare. Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumatat për periudhat përkatëse .

Në bilanc është dhe kolona “shënime” e plotësuar, në të cilën krahas elementëve përkatës të bilancit është shënuar numri i paragrafit në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare në të cilat gjendet informacioni shpjegues për këtë element.

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzhërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit gjithashtu duke hartuar dhe shënimet shpjeguese.

Pasqyrat e pozicionit financiar të ALUIZNI-t Kukës në 31.12.2015 janë si më poshtë:

Pasqyra e aktiveve, detyrimeve dhe kapitali**Formati nr. 1****AKTIVI I BILANCIT KONTABEL 2015***(ne leke)*

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhes	Ndryshim i + -
1	12	Rezultate te mbartura(saldo debitore)			
2	A	AKTIVE TE QENDRUESHME	2,221,863	1,759,551	462,312
3	20, 230	I.Te pa trupezuara	0	0	
9	21,23,24,28	II.Akt.Qendr.te Trupezuara	2,221,863	1,759,551	462,312
18	218	Inventar ekonomik	2625267	2279919	345,348
19	219	Amortizimi aktiv.Qendr.te trupezuara(-)	(403,404)	(520,368)	
24	25.26	III.Aktive Financiare	0	0	
25	25	Huadhenie e nenhuadhenie			
26	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet			
27	B	AKTIVE QARKULLUESE	1,276,100	1,069,479	206,621
28	Klasa 3	I.Gjendja e Inventarit	548,876	222,536	116,964
29	31	Materiale	400,076	93,946	396,130
30	32	Objekte inventari	148,800	128,590	20
38	Klasa 4	II.Kerkesa arketimi mbi debitoret	727,223	684,016	43,207
45	4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	656,423	557,816	96,607
52	468	Debitore te ndryshem	70,800	126,200	
53	49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)			
54	50.59	III.Llogarite financiare	0	162,927	-162,297
57	512	Llogari ne banke			
58	520	Disponibilitete ne thesar	0	162,927	-162,297
64	C	LLOGARI TE TJERA AKTIVE	0	0	
68	85	REZULTATI I USHTRIMIT(saldo debitore)			
69	X	TOTALI I AKTIVIT	3,497,963	2,829,030	668,9933

A. AKTIVET

Aktivitet e qëndrueshme në fund të periudhës ushtrimore janë rritur në zërin aktive të trupëzuara për shumën 462,312 lekë që vijnë nga rritja e inventarit ekonomik, ku sipas paraqitjeve në pasqyrën ndryshimet e aktiveve të qëndrueshmeve (vlera bruto blerje – dalje- minus amortizimin e mbetur) kuadron shumën 2,221,863 lekë.

I. Aktivet afatshkurtra.

- Mjete monetare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Në këtë zë përfshihen kryesisht aktivet monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide. Gjithashtu mund të përfshihen edhe llogaritë hua dhe letra me vlerë, zhvlerësimi i aktiveve financiare nëse plotësojnë kushtin e përkufizimit si ekuivalente të mjeteve monetare.

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë:

-Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" për shumën 162,927 lekë përfaqëson taksën e infrastrukturë gjendje në fund të vitit të ish komunave e bashkive e cila është përdorur në periudhat e më vonshme.

Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Kukës nuk ka llogari të tjera si : Investime afatshkurtra., Depozita në bankë, Llogari të arkëtueshme tregtare.

Aneksi VI ,i gjendjes së llogarive të klientëve (llog. 411)analitike dt. 31.12.2015.

Institucioni ka gjendje debitore të ndryshëm (llog 468) në fund të vitit shumën 70,800 lekë detyrime të punonjësve lëna nga grupi i auditimit i Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.

- Të tjera llogari të arkëtueshme.

Përfshihen të gjitha të drejtat e ndërmarrjes ndaj të tretëve që nuk lindin nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm dhe as nga investimet në letrat me vlerë dhe investime të tjera të mbajtura për tregtim.

Në këtë nënzë paraqiten dhe tepricat **debitore** të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj. kur ato klasifikohen si afatshkurtra. Pra, në këtë zë do të përfshihen **tepricat debitore**, por pa u kufizuar vetëm në to, të llogarive (401-469):

6. Inventari.

Në këtë zë të bilancit jepen informacionet për inventarin gjendje në datën e ndërtimit të bilancit. Paraqitja e gjendjes së këtyre inventarëve bëhet në Bilanc me vlerën neto. Në vartësi të llojit të inventarit ky zë mund të paraqitet i ndarë në disa nën zëra ku paraqiten tepricat e llogarive si: *lëndët e para dhe materialet e konsumueshme si dhe llogaritë e zhvlerësimit të tyre, prodhime në proces dhe gjysëmprodukte, produkte të gatshme, mallra për rishitje, parapagesa për inventar (llog. 371- 376)...*

Në përputhje me SKK nr. 4 e përmirësuar në informacionet plotësuese të pasqyrave financiare në lidhje me inventarët duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm:

(a) politikat kontabël të përdorura si dhe formulat e përdorura për llogaritjen e kostos;

(b) vlerën kontabël të të gjithë inventarëve si dhe vlerën kontabël të tyre sipas klasifikimit të bërë nga njësia ekonomike;

(c) vlerën e inventarëve të njohur si shpenzim gjatë periudhës kontabël;

(d) shumën e ndonjë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme;

(e) vlerën kontabël të inventarit të dhënë si garanci;

(f) vlerën kontabël të inventarëve që janë në ruajtje të palëve të tjera;

(g) informacion mbi inventarin , shumat dhe nëse është e mundur për llogaritjen e vlerës, që nuk janë të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike por që janë në ruajtje të saj.

Inventari me datën 31.10.2015 është detajuar si më poshtë:

Lënda e parë dhe ndihmëse(Materiale)v 400,076

Inventar i imët 148,800

Totali **548,876**

Në analizë:

Aneksi i gjendjes së llogarive 31, 32, (Materiale, inventar i imët, mallra, tjera) në analizë.(Inventarët e kryer në fund të periudhës)

II. Aktivet afatgjata.

1. Aktive afatgjata materiale.

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive R materiale afatgjata sipas SKK 5 i përmirësuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Aktivitet afatgjatë materiale (AAM) janë aktive materiale që:

- (a) përdoren nga njësi ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për tua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe
- (b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepriceve të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

2813. Amortizimi për instalimet teknike, makineritë, pajisjet, instrumente dhe veglat,

- Aktive të tjera afatgjatë materiale.

Në këtë zë paraqiten zakonisht Mobiljet dhe Pajisjet e zyrave si dhe aktive të tjera afatgjatë materiale që nuk përfshihen në grupet e tjera. Sipas përmbajtjes së tij në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

218. Të tjera AA materiale

2181. Mobilje dhe pajisje zyre

2182. Pajisje informative

2188. Të tjera.

291810

Zhvlerësimi për të tjera AA

28+ 18. Për të tjera AA materiale

Aktivitet afatgjatë materiale (neto) janë detajuar si më poshtë:

Inventarizimi i aktiveve në Aluizni Kukës është kryer duke u bazuar në urdhrin e titullarit nr. 3, datë 20.04.2015 për vitin 2015, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet. Komisioni është i përbërë nga Dritan Domi Kryetar dhe Shpresim Mujo, Denada Caka, Bujar Zenelaj Emiriola Veliaj antarë.

Sipas pasqyrës së aktiveve janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjatë materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre nga komisioni i ngritur me Urdhrin e lartpërmendur, "Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin jashtë përdorim" në shumën prej 382,092 lekë e realizuar deri 20.04.2015 e cila i takon aktiveve të vitit 2015, si rrjedhim duhej të ishte reflektuar në aktivet e pasqyrave financiare të viti 2015 dhe ngjarja ka ndodhur pas raportimit financiar. Nga kryerja e inventarit janë listuar materiale për dalje jashtë përdorimit që janë kompetencë e Drejtorisë Përgjithshme të ALUIZNI-t por nuk ka konfirmim prej saj. Materialet e propozuara për dalje jashtë përdorimit janë evidentuar, verifikuar dhe janë vlerësuar të papërdorshme për qëllime të tjera, janë asgjësuar djegur e prerë nga në prezencë të komisionit. Materialet e propozuara për të dalë jashtë përdorimit dhe të asgjësuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, janë hequr nga kontabiliteti sipas flet daljes nr. 10 datë 30.04.2015 për shumën 113,055 lekë. Për sa sipër është mbajtur procesverbali nr. 2 datë 27.04.2015.

Bazuar në situatën në fakt "Për vlerësimin e truallit të objekteve që administrojnë ALUIZNI Kukës" si dhe në zbatim të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", rezulton se nuk ka marrëveshje me Prefekturën Kukës për shfrytëzimin e objekteve pronë e saj me të dhëna sipas hartës së referuar zonës kadastrale që përfshihet në qendër të qytetit ku ndodhen të gjitha objektet e prefekturës. Për rrjedhojë nuk është evidentuar vlera e shpenzimeve për qiranë rikonstrukcionin apo mirëmbajtjen e zyrave në përdorim..

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material. Ligji nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 22, i ndryshuar dhe UMF nr. 5, dt. 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" pika 3.7 "Amortizimi", i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2015 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Aktivitet në proces nuk amortizohen.

Sipas pasqyrës është llogaritur amortizimi i aktiveve të trupëzuara me 31/12/2015

Në çelje të bilancit shuma 520,368, shtesa gjatë vitit shuma 177, 981 , pakësime shuma 294,945, mbetje e akumuluar 403,404 lekë.

B. DETYRIMET

1. Detyrime tatimore

Në këtë zë përfshihen të gjitha detyrimet e njësive ekonomike për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të llogaritura e të papaguara ndaj shtetit si psh TVSH, Tatimi mbi fitimin, Tatimi mbi të Ardhurat Personale, Tatim në Burim, Tatimet e tjera, si dhe për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, kur ato parashikohen që të shlyhen brenda 12 muajve nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare. Në këtë nënzë do të përmbledhen tepricat kreditore të llogarive vijuese:

43. Detyrime për sigurimet shoqërore dhe llogari të lidhura me to;

431. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

437. Organizma të tjera shoqërore

438. Detyrime të tjera

44. Shteti për tatime dhe taksa dhe llogari të lidhura me to;

442. Tatim mbi të ardhurat personale,

443. Tatime të tjera për punonjësit,

444. Tatim mbi fitimin,

445. TVSH,

4453. Shteti-TVSh për t'u paguar,

447. Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer (teprica kreditore),

448. Tatime të shtyra (teprica kreditore),

449. Tatimi në burim,

Detyrimet për vitin e mbyllur janë detajuar si më poshtë:

31/12/2015

- Llog. 431 "Detyrime për sigurime shoqërore & shëndetësore "	38,437 lekë
- Llog 42 "Personeli e llogari të lidhura me to"	395,632 lekë
- Llog. 467 Kreditor të ndryshëm	41,254 lekë
	475,323lekë

3. Grante dhe të ardhura të shtyra;

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten grantet e marra nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur në të ardhura nga njësia ekonomike.

Në këtë zë të detyrimeve afatshkurtër mund të paraqiten tepricat kreditore të llogarive vijuese si:

Llog 72 . Grante korente të përgjithshëm (I brendshëm) 11,281,424 lekë ;

Llog 600, 601 Paga dhe kontribute personeli 8,630,902 lekë

Llog 602 Mallra shërbime 2,650,522 lekë

Shënim:

Për provizionet e raportuara në bilanc, në shënimet shpjeguese nuk është dhënë informacioni si: përshkrimi i tyre; data e parashikuar e realizimit; norma e përdorur për skontimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

provizioneve afatgjata; një rakordim që tregon vlerën kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës; shtesat e bëra gjatë periudhës, duke përfshirë rregullimet që rezultojnë nga ndryshimet në matjen e shumës së skontuar; shumat e ngarkuara kundrejt provizionit gjatë periudhës nëse ka; shumat e papërdorura të anuluar gjatë periudhës; një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit, shumës së pritur, dhe afatit kohor të çdo pagesë që bëhet; një tregues të pasigurive rreth shumës apo kohës së këtyre daljeve, shumën e çdo rimbushim të pritshëm, duke deklaruar shumën e çfarëdo aktiviteti që ka qenë njohur për këtë rimbushim të pritshëm, parashikuar në SKK 6 e përmirësuar:

Vlerësimi i mëpasshëm i provizioneve nuk është kryer nga drejtimi:

Për vitin 2015 ALUIZNI Kukës për çështje gjyqësore të hapura me Vendim të Gjykatës së rrethit nr.449, datë 07.03.,2012 cila konfirmohet nëpërmjet Zyrës së Përmbarimit se është çështje e humbur ALUIZNI nuk ka apeluar këtë vendim nga ana e juristit Teki Elezi veprim i cili ka sjellë pamundësinë për tu gjykuar në shkallët e tjera të gjyqësorit dhe përbën shkelje të disiplinës buxhetore. Për rrjedhojë nuk ka krijuar provizion për këto çështje gjyqësore ku në gjykimin tonë shuma e provizionit duhej të ishte në vlerën totale të detyrimit dhe si rrjedhojë rezultati i periudhës ushtrimore dhe kapitalet e veta janë mbivlerësuar për 224,250 lekë, gjithashtu edhe detyrimet janë nënvlerësuar në të njëjtën vlerë.

“Njësia ekonomike do ta njohë një provizion vetëm kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së raportimit. Që një ngjarje të quhet detyruese, është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për njësinë ekonomike, dhe që njësia ekonomike nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij.”.

Njësia ekonomike do të njohë një provizion në pasqyrat financiare të saj, në lidhje me të gjitha çështjet gjyqësore ekzistuese dhe ato të mundshme, në rastet kur:

- a. një ngjarje detyruese, që ka krijuar çështjen gjyqësore, ka ndodhur para datës së raportimit;
- b. është e mundshme që njësia ekonomike të përballojë shpenzime, në lidhje me zgjidhjen e çështjes gjyqësore;
- c. shuma e shpenzimeve të pritshme, që lidhen me çështjen gjyqësore, mund të vlerësohet relativisht me saktësi.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartpërmendura, provizioni nuk do të njihet në datën e raportimit, por çështjet që lidhen me gjyqin do të përshkruhen si një detyrim i kushtëzuar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Ndonëse shpesh mund të bëhet vetëm një vlerësim i përafërt i shumës që ka të bëjë me çështjet gjyqësore, kjo nuk përbën arsye për mos krijimin e një provizioni. Vetëm në raste të rralla, kur shumat që lidhen me çështjet gjyqësore mund të jenë shuma të ndryshme për skenarë të ndryshëm, dhe probabiliteti i këtyre skenarëve nuk mund të parashikohet me besueshmëri, provizioni nuk do të njihet, por një përshkrim i çështjeve gjyqësore do të paraqitet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

2. Verifikimi i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve:

Pasqyra e Performancës - është një nga pasqyrat financiare që tregon performancën ekonomike (të ardhurat, shpenzimet, fitimin/humbjen e vitit dhe të ardhurat gjithëpërfshirëse) të drejtorisë gjatë një periudhe kontabël. Ky set është i përbërë nga dy pasqyra:

* *Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve* - Pasqyra financiare që paraqet të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës, me përjashtim të zërave të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

* *Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse* - Pasqyra financiare që paraqet fitim/humbja e vitit dhe të gjithë zërat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që sjellin ndryshime në kapital.

Pasqyra e performancës (të ardhurat dhe shpenzimet) për vitin e mbyllur më 31.12.2015 Aluizni Kukës

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

lekë

	Përshkrimi i elementeve	31/12/2015	31/12/2014
A	Të ardhura		
	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		
	Të ardhura jo tatimore	25,734,019	3,592,517
	Grante korente	11,281,424	9,098,135
	Totali	37,015,433	13,318,053
B	SHpenzimet		
	Shpenzime Korente	11,281,424	9,098,135
	Minus Ndryshimin e gjendjeve të inventarit	326,340	93,946
	Totali	10,955,084	9,004,189
	Operacione të korigjimit të rezultatit	26,060,359	4,313,864
	Totali operacioneve	37,015,433	13,318,053

Sipas SKK nr. 2 të përmirësuar, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.

Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:

(a) Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare);

- Shpenzime amortizimi.

Shpenzimet e amortizimit detajohen si më poshtë në pasqyrën formati 7 të bilancit :

31/12/2015 -(Llog. 219) Shpenzime amortizimi 177,981 lekë shuma e akumuluar 403,404 lekë

5. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit.

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjrobat dhe penalitetet si më poshtë:

	<u>31/12/2015</u>
- (Llog. 7115) Gjropa dhe dëmshpërblime	214,838

Trajtuar te pika më poshtë te Analiza e shpenzimeve:

(Aneksi VIII)

Në analizë shpenzimet si më poshtë:

Shpenzimet	2015	2014	%
- Lëndë e parë, materiale të konsumuara	2,650,522	1,809,392	18.3
- Udhëtime dhe dieta	794,590	780,860	0,005
Llog 6020 - materiale zyre e të përgjithshme	797,800	223,153	
- Të tjera	365,279	259,819	
- shpenzime transporti i	377,853	339,960	
- (Llog. 641) Shpenzime për paga	7,401,079	5,852,122	51.3
- (Llog. 644) Shpenzime për sig. Shoq. e shend.	1,229,283	972,147	
Llog 6025 Shpenzime mirëmbajtje	794,590	780,860	
- (Llog. 6039) Shpenzime tjera operative	45	0	
TOTALI	14,411,041	10,678,353	

Në totalin e shpenzimeve për vitin 2015; zërat kryesore ndaj totalit zënë:

- Shpenzimet për lëndë të para e materiale të konsumuara ndaj totalit zënë 18.3 %.
- Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shëndetësorë dhe shoqërore ndaj totalit zënë 51.3 %.
- Shpenzimet për udhëtime e dieta zënë 0,005 %.

B.1.2. Auditimi i pasqyrave financiare viti 2016.

1. Nga verifikimi formal i pasqyrave financiare për vitin 2016 rezultoi se janë:

- bilanci,
- pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve,
- pasqyra e ndryshimeve në kapital,
- pasqyra e fluksit të parësë si dhe aneksi për shënimet shpjeguese.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Hartimi i pasqyrave financiare bazohet në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"), të përcaktuara në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Pasqyrat financiare të vitit 2016 janë miratuar me datë 13.02.2017, brenda afatit ligjor të mbylljes, i cili është shoqëruar me relacion nga Sektorit i Buxhetit dhe Financës për "Raporti mbi realizimin e treguesve ekonomik financiar dhe miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2016".

Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të ALUIZNI-t Kukës në fund të periudhës kontabël dt. 31.12.2016.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë:

- Aktivët, Detyrimet, Kapitali.

Klasifikimi i elementeve të mësipërme në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sigurtë të situatës financiare. Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse.

Në bilanc është dhe kolona "shënime" e plotësuar, në të cilën krahas elementëve përkatës të bilancit është shënuar numri i paragrafit në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare në të cilat gjendet informacioni shpjegues për këtë element.

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzhërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit gjithashtu duke hartuar dhe shënimet shpjeguese.

Pasqyrat e pozicionit financiar të ALUIZNI-t Kukës në 31.12.2016 janë si më poshtë:

Pasqyra e aktiveve, detyrimeve dhe kapitali

Formati nr. 1

AKTIVI I BILANCIT KONTABEL 2016

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhes	Ndryshimi + -
1	12	Rezultate te mbartura(saldo debitoare)			
2	A	AKTIVE TE QENDRUESHME	2,057,288	2,221,863	-164,575
3	20, 230	I.Te pa trupezuara	0	0	
9	21,23,24,28	II.Akt.Qendr.te Trupezuara	2,057,288	2,221,863	-164,575
18	218	Inventar ekonomik	2,762,510	2,625,267	137,243
19	219	Amortizimi aktiv.Qendr.te trupezuara(-)	(705,222)	(403,404)	299,818
24	25.26	III.Aktive Financiare			
25	25	Huadhenie e nenhuadhenie			
26	26	Pjesmarje ne kapitalin e vet			
27	B	AKTIVE QARKULLUESE	1,211,022	1,276,099	-65,077
28	Klasa 3	I.Gjendja e Inventarit	520,367	548,876	-28,509
29	31	Materiale	386,567	400,076	-13,509
30	32	Objekte inventari	133,800	148,800	-15,000
38	Klasa 4	II.Kerkesa arketimi mbi debitorët	690,655	727,233	34,232
45	4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	650,655	656,423	-5,768
52	468	Debitorë te ndryshëm	40,000	70,800	-30,800
53	49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)			



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

54	50.59	III.Llogarite financiare			
57	512	Llogari ne banke			
58	520	Disponibilitete ne thesar			
64	C	LLOGARI TE TJERA AKTIVE			
68	85	REZULTATI I USHTRIMIT(saldo debitore)			
69	X	TOTALI I AKTIVIT	3,268,810	3,497,962	-229,152

A. AKTIVET

Aktivet e qëndrueshme në fund të periudhës ushtrimore krahasuar me periudhën e ushtrimit paraardhës janë pakësuar në zërin aktive të trupëzuara për shumën lekë **-164,575** që vijnë nga rritja e inventarit ekonomik, ku sipas paraqitjeve në pasqyrën ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto blerje – dalje- minus amortizimin e mbetur) kuadron shumën 2,057,288 lekë.

I. Aktivet afatshkurtra.

- Mjete monetare.

Në këtë zë përfshihen kryesisht aktivet monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide. Gjithashtu mund të përfshihen edhe llogaritë hua dhe letra me vlerë, zhvlerësimi i aktiveve financiare nëse plotësojnë kushtin e përkufizimit si ekuivalente të mjeteve monetare.

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë:

-Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” për shumën 162,927 lekë në periudhën paraardhëse të vitit 2015, nuk ka dalë më në bilancin e vitit 2016 pasi është kaluar në thesar si taksë e infrastrukturë se ish komunave e bashkive dhe është përdorur në periudhat e mëvonshme.

ALUIZMI Kukës nuk ka llogari të tjera si : Investime afatshkurtra., Depozita në bankë, Llogari të arkëtueshme tregtare.

Aneksi VI,i gjendjes së llogarive të klientëve (llog 411)analitike dt. 31.12.2016.

Institucioni ka gjendje debitore ne fund te vitit shumën 40,000 lekë e cila në krahasim me vitin e mëparshëm është pakësuar.

Në analizë kjo llogari është pakësuar për shumën 30,800 lekë dhe teprica e vitit 2016 tregon pjesën në proces të arkëtimit të detyrime nga punonjësit.

- Të tjera llogari të arkëtueshme.

Përfshihen të gjitha të drejtat e ndërmarrjes ndaj të tretëve që nuk lindin nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm dhe as nga investimet në letrat me vlerë dhe investime të tjera të mbajtura për tregtim.

Në këtë nën zë paraqiten dhe tepricat **debitore** të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj. kur ato klasifikohen si afatshkurtra. Pra, në këtë zë do të përfshihen **tepricat debitore**, por pa u kufizuar vetëm në to, të llogarive (401-469):

6. Inventari.

Në këtë zë të bilancit jepen informacionet për inventarin gjendje në datën e ndërtimit të bilancit. Paraqitja e gjendjes së këtyre inventarëve bëhet në Bilanc me vlerën neto. Në vartësi të llojit të inventarit ky zë mund të paraqitet i ndarë në disa nënzëra ku paraqiten tepricat e llogarive si: *lëndët e para dhe materialet e konsumueshme si dhe llogaritë e zhvlerësimit të tyre, prodhime në proces dhe gjysmë produkte, produkte të gatshme, mallra për rishitje, parapagesa për inventar (llog. 371- 376)...*

Në përputhje me SKK nr. 4 e përmirësuar në informacionet plotësuese të pasqyrave financiare në lidhje me inventarët duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm:

(a) politikat kontabël të përdorura si dhe formulat e përdorura për llogaritjen e kostos;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

- (b) vlerën kontabël të të gjithë inventarëve si dhe vlerën kontabël të tyre sipas klasifikimit të bërë nga njësia ekonomike;
- (c) vlerën e inventarëve të njohur si shpenzim gjatë periudhës kontabël;
- (d) shumën e ndonjë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme;
- (e) vlerën kontabël të inventarit të dhënë si garanci;
- (f) vlerën kontabël të inventarëve që janë në ruajtje të palëve të tjera;
- (g) informacion mbi inventarin, shumat dhe nëse është e mundur përllogaritjen e vlerës, që nuk janë të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike por që janë në ruajtje të saj.

Inventari me datën 31.10.2016 është detajuar si më poshtë:

Lënda e parë dhe ndihmëse (Materiale)	386,567
Inventar i imët	<u>133,800</u>
Totali	520, 367

Në analizë:

Aneksi i gjendjes së llogarive 31, 32, (Materiale, inventar i imët, mallra, tjera) në analizë. (Inventarët e kryer në fund të periudhës)

II. Aktivet afatgjata.

1. Aktive afatgjata materiale.

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive R materiale afatgjata sipas SKK 5 i përmirësuar.

Aktivët afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që:

- (a) përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për tua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe
- (b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepërcave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

2813. Amortizimi për instalimet teknike, makineritë, pajisjet, instrumente dhe veglat,

- Aktive të tjera afatgjata materiale.

Në këtë zë paraqiten zakonisht Mobiljet dhe Pajisjet e zyrave si dhe aktive të tjera afatgjata materiale që nuk përfshihen në grupet e tjera. Sipas përmbajtjes së tij në këtë nënzë do të përfshihen tepërcat e llogarive si vijon:

218. Të tjera AA materiale

2181. Mobilje dhe pajisje zyre

2182. Pajisje informative

2188. Të tjera.

291810

Zhvlerësimi për të tjera AA

28+ 18. Për të tjera AA materiale

Aktivët afatgjata materiale (neto) janë detajuar si më poshtë:

Inventarizimi i aktiveve në Aluizni Kukës është kryer duke u bazuar në urdhrin e titullarit nr. 42, datë 20.12.2016 për vitin 2016, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet. Komisioni është i përbërë nga N. Sh., Kryetare dhe A.G., M. L., antarë.

Sipas pasqyrës së aktiveve janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimi dhe asgjësimin e tyre nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr 44, datë 30.12.2016 "Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin jashtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

përdorim” në shumën prej 60,577 lekë e realizuar deri 30.12.2016 e cila i takon aktiveve të vitit 2016, si rrjedhim duhej të ishte reflektuar në aktivet e pasqyrave financiare të viti 2016 dhe ngjarja ka ndodhur para raportimit financiar. Nga kryerja e inventarit janë listuar materiale për dalje jashtë përdpromit që janë kompetencë e Drejtorisë Përgjithshme të ALUIZNI-t.e cila është njoftuar me shkresë nr. 1021 prot. datë 6.012.2016, por nuk ka konfirmim prej saj. Materialet e propozuara për jashtë përdorimit janë evidentuar, verifikuar dhe janë vlersuar të papërdorshme për qëllime të tjera , janë asgjësuar djegur e prerë në prezencë të komisionit. Materialet e propozuara për të dalë jashtë përdorimit dhe të asgjësuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, janë hequr nga kontabiliteti sipas flet daljes nr. 15 datë 30.12.2016 për shumën 88,306 lekë. Për sa sipër është mbajtur procesverbali nr. 3 datë 30.12.2016.

Bazuar në VKM nr. 289, datë 17.05. 2006, pika 10, dhe 11 e tij, sipas situatës në fakt “Për vlerësimin e trullit të objekteve që administron ALUIZNI Kukës ” si dhe në zbatim të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se nuk ka marrëveshje me Prefekturën Kukës për shfrytëzimin e objekteve pronë e saj me të dhëna sipas hartës së referuar zonës kadastrale që përfshihet në qendër të qytetit ku ndodhen të gjitha objektet e prefekturës. Për rrjedhojë nuk ka marrëveshje me Prefekturën për per evidentimin në kontabilitet të vlerës së shpenzimeve të rikonstruksionit mirëmbajtjen, e amortizim të zyrave në përdorim në përpunje me planin unik kontabël. Këto shpenzime duhen mbajtur në kontabilitetin e ALUIZNI-t dhe në fund të cdo viti të transferohen në bilancin e Prefekturës duke bërë të mundur ruajtjen e historikut të aktiveve të saj.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material. Ligji nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 22, i ndryshuar dhe UMF nr. 5, dt. 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” pika 3.7 “Amortizimi”, i ndryshuar.

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2016 janë si më poshtë:

<u>Kategoria e aktiveve</u>	<u>Metoda e Amortizimit</u>	<u>Norma e Amortizimit</u>
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobileje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Aktivitet në proces nuk amortizohen.

Sipas pasqyrës është llogaritur amortizimi i aktiveve të trupëzuara me 31/12/2016

Në Celje të bilancit shuma mbetje e akumuluar 403,404 lekë, shtesa gjatë vitit shuma 324,669 , pakësime shuma 22,851 duke mbetur në mbyllje shuma e akumuluar 705,222 lekë.,

B. DETYRIMET

1. Detyrime tatimore

Në këtë zë përfshihen të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të llogaritura e të papaguara ndaj shtetit si p.sh. TVSH, Tatimi mbi fitimin, Tatimi mbi të Ardhurat Personale, Tatim në Burim, Tatimet e tjera, si dhe për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, kur ato parashikohen që të shlyhen brenda 12 muajve nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare. Në këtë nënzë do të përmbledhen tepricat kreditore të llogarive vijuese:

43. Detyrime për sigurimet shoqërore dhe llogari të lidhura me to;

431. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

437. Organizma të tjera shoqërore

438. Detyrime të tjera

44. Shteti për tatime dhe taksa dhe llogari të lidhura me to;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

442. Tatim mbi të ardhurat personale,
 443. Tatime të tjera për punonjësit,
 444. Tatim mbi fitimin,
 445. TVSH,
 4453. Shteti-TVSh për t'u paguar,
 447. Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer (teprica kreditore),
 448. Tatime të shtyra (teprica kreditore),
 449. Tatimi në burim,

Detyrimet për vitin e mbyllur janë detajuar si më poshtë:

	<u>31/12/2016</u>
- Llog. 431 "Detyrime për sigurime shoqërore & shëndetësore"	32,037 lekë
- Llog 42 "Personeli e llogari të lidhura me to"	399,920 lekë
- Llog. 467 Kreditor të ndryshëm	<u>82,978</u> lekë
Totali	514,935 lekë

3. Grante dhe të ardhura të shtyra;

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten grantet e marra nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur në të ardhura nga njësia ekonomike.

Në këtë zë të detyrimeve afatshkurtër mund të paraqiten tepricat kreditore të llogarive vijuese si:

Llog 72 . Grante korente të përgjithshëm (I brendshëm)	11,967,343 lekë ;
Llog 600, 601 Paga dhe kontribute personeli	8,294,019 lekë
Llog 602 Mallra shërbime	<u>2,285,724</u> lekë

Totali 22,547,086

Shënim:

Për provizionet e raportuara në bilanc, në shënimet shpjeguese nuk është dhënë informacioni si: përshkrimi i tyre; data e parashikuar e realizimit; norma e përdorur për skontimin e provizioneve afatgjata; një rakordim që tregon vlerën kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës; shtesat e bëra gjatë periudhës, duke përfshirë rregullimet që rezultojnë nga ndryshimet në matjen e shumës së skontuar; shumat e ngarkuara kundrejt provizionit gjatë periudhës nëse ka; shumat e papërdorura të anuluar gjatë periudhës; një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit, shumës së pritur, dhe afatit kohor të çdo pagesë që bëhet; një tregues të pasigurive rreth shumës apo kohës së këtyre daljeve, shumën e çdo rimbursim të pritshëm, duke deklaruar shumën e çfarëdo aktiviteti që ka qenë njohur për këtë rimbursim të pritshëm, parashikuar në SKK 6 e përmirësuar:

Vlerësimi i mëpasshëm i provizioneve nuk është kryer nga drejtimi:

Për vitin 2016 ALUIZNI Kukës nuk ka çështje gjyqësore të hapura.

2. Verifikimi i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve:

Pasqyra e Performancës - është një nga pasqyrat financiare që tregon performancën ekonomike (të ardhurat, shpenzimet, fitimin/humbjen e vitit dhe të ardhurat gjithëpërfshirëse) të drejtorisë gjatë një periudhe kontabël. Ky set është i përbërë nga dy pasqyra:

* *Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve* - Pasqyra financiare që paraqet të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës, me përjashtim të zërave të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

* *Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse* - Pasqyra financiare që paraqet fitim/humbja e vitit dhe të gjithë zërat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që sjellin ndryshime në kapital.

Pasqyra e performancës (të ardhurat dhe shpenzimet) për vitin e mbyllur më 31.12.2016 ALUIZNI Kukës

lekë

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

	Përshkrimi i elementeve	31/12/2016	31/12/2015
A	Të ardhura		
	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		
	Të ardhura jo tatimore	14,569,059	25,734,019
	Grante korente	11,967,343	11,281,424
	Totali	26,536,402	37,015,433
B	Shpenzimet		
	Shpenzime Korente	11,967,343	11,281,424
	Minus Ndryshimin e gjendjeve të inventarit	28,509	326,340
	Totali	11,938,834	10,955,084
	Operacione të korrigjimit të rezultatit	26,564,911	26,060,359
	Totali operacioneve	26,564,911	37,015,433

Sipas SKK nr. 2 të përmirësuar, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.

Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:

(a) Efektet e korrigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare);

- Shpenzime amortizimi.

Shpenzimet e amortizimit detajohen si më poshtë në pasqyrën formati 7 të bilancit :

31/12/2015-(Llog. 219) Shpenzime amortizimi 177,981 lekë shuma e akumuluar 403,404 lekë

5. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit.

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet si më poshtë:

31/12/2016

- (Llog. 7115) Gjoka dhe dëmshpërblime **20,430**

Trajtuar te pika më poshtë te Analiza e shpenzimeve:

(Aneksi VIII)

Në analizë shpenzimet si më poshtë:

Shpenzimet	2016	2015	%
- Lëndë e parë, materiale të konsumuara	2,285,724	2,650,522	10.7
- Udhëtime dhe dieta	627,260	794,590	
-Llog 6020 - materiale zyre e të përgjithshme	567,830	797,800	
-Shërbime nga të tretë	346,473	365,279	
- shpenzime transporti i	379,709	377,853	
-shpenzime mirëmbajtje të zakonëshme	364,000	259,700	
- Të tjera	20,452	45,300	
Ndryshimi I gjendjeve të inventarit	28,509	326,340	
- (Llog. 641) Shpenzime për paga	8,294,019	7,401,079	31.2
- (Llog. 644) Shpenzime për sig. Shoq. e shend.	1,367,600	1,229,823	
TOTALI SHPENZIMEVE	11,995,852	10,955,084	
Operacione të rezultatit	14,569,059	20,060,359	54.8
- (Llog. 6039) Shpenzime tjera operative	20,452	0	
TOTALI	26,564,911	37,015,433	

Në strukturën e shpenzimeve për vitin 2016; zërat kryesore ndaj totalit zënë:

- Shpenzimet për lëndë të para e materiale të konsumuara ndaj totalit zënë 10.7 %.
- Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shëndetësorë dhe shoqërore ndaj totalit zënë 31,2 %.
- Shpenzimet për udhëtime e dieta zënë 2.3 %.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

B.1.3. Auditimi i pasqyrave financiare viti 2017.

1. Nga verifikimi formal i pasqyrave financiare për vitin 2017 rezultoi se janë:

- *bilanci*, - *pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve*, - *pasqyra e ndryshimeve në kapital*, - *pasqyra e fluksit të parësë si dhe aneksi për shënimet shpjeguese*.

Hartimi i pasqyrave financiare bazohet në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"), të përcaktuara në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Pasqyrat financiare të vitit 2017 janë miratuar me datë 13.02.2017, brenda afatit ligjor të mbylljes, i cili është shoqëruar me relacion nga Sektorit i Buxhetit dhe Financës për "Raporti mbi realizimin e treguesve ekonomik financiar dhe miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2017".

Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të ALUIZNI-t Kukës në fund të periudhës kontabël dt. 31.12.2017.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë:

- *Aktivitet, Detyrimet, Kapitali*.

Klasifikimi i elementeve të mësipërme në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sigurtë të situatës financiare. Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse.

Në bilanc është dhe kolona "shënime" e plotësuar, në të cilën krahas elementëve përkatës të bilancit është shënuar numri i paragrafit në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare në të cilat gjendet informacioni shpjegues për këtë element.

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzhërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit gjithashtu duke hartuar dhe shënimet shpjeguese.

Pasqyrat e pozicionit financiar të ALUIZNI-t Kukës në 31.12.2017 janë si më poshtë:

Pasqyra e aktiveve, detyrimeve dhe kapitali

Formati nr. 1

AKTIVI I BILANCIT KONTABEL 2017

(ne leke)

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhes	Ndryshimi + -
1	12	Rezultate te mbartura(saldo debitore)			
2	A	AKTIVE TE QENDRUESHME			
3	20, 230	I.Te pa trupezuara	0	0	
9	21,23,24,28	II.Akt.Qendr.te Trupezuara	2,690,650	2,057,288	633,362
18	218	Inventar ekonomik	3,427,442	2,762,510	664,932
19	219	Amortizimi aktiv.Qendr.te trupezuara(-)	(736,792)	(705,222)	(31,570)
24	25.26	III.Aktive Financiare			
25	25	Huadhenie e nenhuadhenie			
26	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet			
27	B	AKTIVE QARKULLUESE	1,091,174	1,211,022	-119,848
28	Klasa 3	I.Gjendja e Inventarit	535,341	520,367	14,974
29	31	Materiale	430,541	386,567	43,974
30	32	Objekte inventari	104,800	133,800	-29,000
38	Klasa 4	II.Kerkesa arketimi mbi debitorët	556,373	690,655	-134,282
45	4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	535,373	650,655	-115,282



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

52	468	Debitore te ndryshem			
53	49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)			
54	50.59	III.Llogarite financiare			
57	512	Llogari ne banke			
58	52O	Disponibilitete ne thesar			
64	C	LLOGARI TE TJERA AKTIVE			
68	85	REZULTATI I USHTRIMIT(saldo debitoare)			
69	X	TOTALI I AKTIVIT	3,782,364	3,268,310	514,054

B. AKTIVET

Aktivet e qëndrueshme në fund të periudhës ushtrimore janë rritur në zërin aktive të trupëzuara për shumën 633,362 lekë që vijnë nga rritja e inventarit ekonomik, ku sipas paraqitjeve në pasqyrën ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme, e (vlera bruto blerje – dalje- minus amortizimin e mbetur) kuadron shumën 3,427,442 lekë.

I. Aktivet afatshkurtra.

. Mjete monetare.

Në këtë zë përfshihen kryesisht aktivet monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide. Gjithashtu mund të përfshihen edhe llogaritë hua dhe letra me vlerë, zhvlerësimi i aktiveve financiare nëse plotësojnë kushtin e përkufizimit si ekuivalente të mjeteve monetare.

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë:

-Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” si është shpjeguar nuk del në bilancin e vitit 2017. përfaqëson taksën e infrastrukturë se ish komunave e bashkive e cila është përdorur në periudhat e mëvonëshme.

ALUIZNI Kukës nuk ka llogari të tjera si : Investime afatshkurtra., Depozita në bankë, Llogari të arkëtueshme tregtare.

Aneksi VI, i gjendjes së llogarive të klientëve (llog 411) analitike dt. 31.12.2017.

Institucioni ka gjendje debitore për operacione me shtetin në fund të viti për shumën 535,373 lekë.

- Të tjera llogari të arkëtueshme.

Përfshihen të gjitha të drejtat e ndërmarrjes ndaj të tretëve që nuk lindin nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm dhe as nga investimet në letrat me vlerë dhe investime të tjera të mbajtura për tregtim.

Në këtë nënzë paraqiten dhe tepricat **debitore** të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj. kur ato klasifikohen si afatshkurtra. Pra, në këtë zë do të përfshihen **tepricat debitoare**, por pa u kufizuar vetëm në to, të llogarive (401-469):

6. Inventari.

Në këtë zë të bilancit jepen informacionet për inventarin gjendje në datën e ndërtimit të bilancit. Paraqitja e gjendjes së këtyre inventarëve bëhet në Bilanc me vlerën neto. Në vartësi të llojit të inventarit ky zë mund të paraqitet i ndarë në disa nën zëra ku paraqiten tepricat e llogarive si: *lëndët e para dhe materialet e konsumueshme si dhe llogaritë e zhvlerësimit të tyre, prodhime në proces dhe gjysmë produkte, produkte të gatshme, mallra për rishitje, parapagesa për inventar (llog. 371- 376)...*

Në përputhje me SKK nr. 4 e përmirësuar në informacionet plotësuese të pasqyrave financiare në lidhje me inventarët duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm:

(a) politikat kontabël të përdorura si dhe formulat e përdorura për llogaritjen e kostos;

(b) vlerën kontabël të të gjithë inventarëve si dhe vlerën kontabël të tyre sipas klasifikimit të bërë nga njësia ekonomike;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

- (c) vlerën e inventarëve të njohur si shpenzim gjatë periudhës kontabël;
- (d) shumën e ndonjë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme;
- (e) vlerën kontabël të inventarit të dhënë si garanci;
- (f) vlerën kontabël të inventarëve që janë në ruajtje të palëve të tjera;
- (g) informacion mbi inventarin, shumat dhe nëse është e mundur përlllogaritjen e vlerës, që nuk janë të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike por që janë në ruajtje të saj.

Inventari me datën 31.10.2017 është detajuar si më poshtë:

Lënda e parë dhe ndihmëse(Materiale)	llog 31	430,541
Inventar i imët	<u>104,800</u>	
Totali	535,341	

Në analizë:

Aneksi i gjendjes së llogarive 31, 32, (Materiale, inventar i imët, mallra, tjera) në analizë.(Inventarët e kryer në fund të periudhës)

II. Aktivët afatgjata.

1. Aktive afatgjata materiale.

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive rezervave materiale afatgjata sipas SKK 5 i përmirësuar.

Aktivët afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që:

- (a) përdoren nga njësi ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për tua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe
- (b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nën zërave të këtij grupi të bilancit:

2813. Amortizimi për instalimet teknike, makineritë, pajisjet, instrumente dhe veglat,

.- Aktive të tjera afatgjata materiale.

Në këtë zë paraqiten zakonisht Mobiljet dhe Pajisjet e zyrave si dhe aktive të tjera afatgjata materiale që nuk përfshihen në grupet e tjera. Sipas përmbajtjes së tij në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

218. Të tjera AA materiale

2181. Mobilje dhe pajisje zyre

2182. Pajisje informative

2188. Të tjera.

291810

Zhvlerësimi për të tjera AA

28+ 18. Për të tjera AA materiale

Aktivët afatgjata materiale (neto) janë detajuar si më poshtë:

Inventarizimi i aktiveve në Aluizni Kukës është kryer duke u bazuar në urdhrin e titullarit nr. 55, datë 20.11.2017 për vitin 2016, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet. Komisioni është i përbërë nga N. Sh., Kryetar dhe A. G., M.L. anëtarë. Me urdher të Drejtorit V. S. nr. 56 datë 30.11.2017 është ngritur komisioni për vlerësimin e materialeve që duhet të dalin jashtë përdorimit i përbërë nga N. Sh. Kryetare, dhe M. L., A. G. anëtar.

Sipas pasqyrës së aktiveve janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimi dhe asgjësimin e tyre nga komisioni i ngritur me Urdhrin e lartpërmendur, "Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin jashtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

përdorim" në shumën prej 325,868 lekë e realizuar deri 31.12.2017, e cila i takon aktiveve të vitit 2017 si rrjedhim duhet të ishte reflektuar në aktivet e pasqyrave financiare të viti 2017 dhe ngjarja ka ndodhur pas raportimit financiar. Nga kryerja e inventarit janë listuar materiale për dalje jashtë përdorimit që janë kompetencë e Drejtorisë Përgjithshme të ALUIZNI-t por nuk ka konfirmim prej saj. Materialet e propozuara për dalje përdorimit janë evidentuar, verifikuar dhe janë vlerësuar të papërdorshme për qëllime të tjera, janë asgjësuar djegur e prerë nga në prezencë të komisionit. Materialet e propozuara për të dalë jashtë përdorimit dhe të asgjësuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim sipas urdhrit nr. 57, datë 11.12.2017 janë hequr nga kontabiliteti sipas flet daljes nr. 13 datë 11.12.2017 për shumën 296, 868 lekë. Për sa sipër është mbajtur procesverbali nr. 1, 2, 3, 4, datë 06.12.2017.

Bazuar në situatën në fakt "Për vlerësimin e truallit të objekteve që administrojnë ALUIZNI Kukës" si dhe në zbatim të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", rezulton se nuk ka marrëveshje me Prefekturën Kukës për shfrytëzimin e objekteve pronë e saj me të dhëna sipas hartës së referuar zonës kadastrale që përfshihet në qendër të qytetit ku ndodhen të gjitha objektet e prefekturës. Për rrjedhojë mbetet i njëjti problem i konstatuar edhe në bilancet e viteve të mëparshme ku rezulton se nuk është evidentuar vlera e shpenzimeve për mirëmbajtjen e zyrave në përdorim..

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material. Ligji nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 22, i ndryshuar dhe UMF nr. 5, dt. 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" pika 3.7 "Amortizimi", i ndryshuar.

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2017 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Aktiviteti në proces nuk amortizohet.

Sipas pasqyrës është llogaritur amortizimi i aktiveve të trupëzuara me 31/12/2017

Në çelje të bilancit shuma 705,222, shtesa gjatë vitit shuma 261,964, pakësime shuma 294,945 lekë dhe mbetje e akumuluar 403,404 lekë 736,792 lekë..

B. DETYRIMET

1. Detyrime tatimore

Në këtë zë përfshihen të gjitha detyrimet e njësive ekonomike për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të llogaritura e të papaguara ndaj shtetit si p.sh. TVSH, Tatimi mbi fitimin, Tatimi mbi të Ardhurat Personale, Tatim në Burim, Tatimet e tjera, si dhe për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, kur ato parashikohen që të shlyhen brenda 12 muajve nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare. Në këtë nënzë do të përmbledhen tepricat kreditore të llogarive vijuese:

43. Detyrime për sigurimet shoqërore dhe llogari të lidhura me to;

431. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore

437. Organizma të tjera shoqërore

438. Detyrime të tjera

44. Shteti për tatime dhe taksa dhe llogari të lidhura me to;

442. Tatim mbi të ardhurat personale,

443. Tatime të tjera për punonjësit,

444. Tatim mbi fitimin,

445. TVSH,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

4453. Shteti-TVSh për t'u paguar,

447. Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer (teprica kreditore),

448. Tatime të shtyra (teprica kreditore),

449. Tatimi në burim,

Detyrimet për vitin e mbyllur janë detajuar si më poshtë:

31/12/2017

- Llog. 434,435,436,467 "Detyrime për sigurime shoqërore & shëndetësore etj	160145	lekë
- Llog 42 "Personeli e llogari të lidhura me to"	365,497	lekë
-Llog. 431 Kreditor të ndryshëm (Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa)	<u>30,731</u>	lekë
Totali	556373	lekë

3. Grante dhe të ardhura të shtyra;

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten grantet e marra nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur në të ardhura nga njësia ekonomike.

Në këtë zë të detyrimeve afatshkurtër mund të paraqiten tepricat kreditore të llogarive vijuese si:

Llog 72 . Grante korente të përgjithshëm (I brendshëm) 10,994,075 lekë ;

Llog 600, 601 Paga dhe kontribute personeli 7,601,677 lekë

Llog 602 Mallra shërbime 2,130,408 lekë

Shënim:

Për provizionet e raportuara në bilanc, në shënimet shpjeguese nuk është dhënë informacioni si: përshkrimi i tyre; data e parashikuar e realizimit; norma e përdorur për skontimin e provizioneve afatgjata; një rakordim që tregon vlerën kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës; shtesat e bëra gjatë periudhës, duke përfshirë rregullimet që rezultojnë nga ndryshimet në matjen e shumës së skontuar; shumat e ngarkuara kundrejt provizionit gjatë periudhës nëse ka; shumat e papërdorura të anuluar gjatë periudhës; një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit, shumës së pritur, dhe afatit kohor të çdo pagesë që bëhet; një tregues të pasigurive rreth shumës apo kohës së këtyre daljeve, shumën e çdo rimbursimi të pritshëm, duke deklaruar shumën e çfarëdo aktiviteti që ka qenë njohur për këtë rimbursim të pritshëm, parashikuar në SKK 6 e përmirësuar:

Vlerësimi i mëpasshëm i provizioneve nuk është kryer nga drejtimi:

Për vitin 2017 ALUIZNI Kukës nuk ka çështje gjyqësore të hapura.

"Njësia ekonomike do ta njohë një provizion vetëm kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së raportimit. Që një ngjarje të quhet detyruese, është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për njësinë ekonomike, dhe që njësia ekonomike nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij."

2. Verifikimi i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve:

Pasqyra e Performancës - është një nga pasqyrat financiare që tregon performancën ekonomike (të ardhurat, shpenzimet, fitimin/humbjen e vitit dhe të ardhurat gjithëpërfshirëse) të drejtorisë gjatë një periudhe kontabël. Ky set është i përbërë nga dy pasqyra:

* Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve - Pasqyra financiare që paraqet të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës, me përjashtim të zërave të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

* Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse - Pasqyra financiare që paraqet fitim/humbja e vitit dhe të gjithë zërat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që sjellin ndryshime në kapital.

Pasqyra e performancës (të ardhurat dhe shpenzimet) për vitin e mbyllur më 31.12.2017
Aluizni Kukës

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

lekë

	Përshkrimi i elementeve	31/12/2017	31/12/2015
A	Të ardhura		
	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		
	Të ardhura jo tatimore	7034,371	14,569,059
	-Shërbime administrative e të ardhura sekondare	7015,271	14,569,059
	-Gjoha kamat vonesa sekuestreime e zhdëmtime	55,021	20,430
	Grante korente	10,994,075	11,967,343
	Totali	18,028,346	26,536,402
B	Shpenzimet		
	Shpenzime Korente	10,994,075	11,967,343
	Minus Ndryshimin e gjendjeve të inventarit	14,974	28,509
	Totali	10,979,101	11,995,852
	Operacione të korigjimit të rezultatit	7,049,245	14,540,550
	Totali operacioneve	18,028,346	26,536,402

Sipas SKK nr. 2 të përmirësuar, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.

Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:

(a) Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare);

- Shpenzime amortizimi.

Shpenzimet e amortizimit detajohen si më poshtë në pasqyrën formati 7 të bilancit :

31/12/2017 -(Llog. 219) Shpenzime amortizimi shuma 705,222 lekë në çelje të bilancit shtohen llogaritjet vjetore shuma 261,964 lekë minus pakësimet nga daljet jashtë përdorimit shuma 230,394 lekë mbetet në mbyllje shuma e akumuluar 736,792 lekë,

5. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit.

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet si më poshtë:

31/12/2017

- (Llog. 7115) Gjoka dhe dëmshpërblime 55,021 lekë

Në fund të vitit 2017 vazhdon të jetë e pa arkëtuar shuma debitore ndaj z. R. G., për shumën 21,000 lekë detyrë e lënë nga auditimi i brendshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t. Nga Zyra e ALUIZNI-t Kukës është njoftuar disa herë dhe e fundit është shkresa nr. 118 datë 31.07.2017.

Në analizë shpenzimet si më poshtë:

Shpenzimet	2017	2016	%
- Lëndë e parë, materiale të konsumuara	2,130,408	2,285,574	11.8
- Udhëtime dhe dieta	426,530	627,670	
Llog 6020 - materiale zyre e të përgjithshme	453,171	547,830	
- Të tjera			
- shpenzime transporti i	399,950	379,473	
- (Llog. 600) Shpenzime për paga	7,601,677	8,284,019	42.1
- (Llog.601) Shpenzime për sig. Shoq. e shend.	1,261,990	1,387,600	7.0
Llog 6025 Shpenzime mirëmbajtje	259,292	364,000	
- (Llog. 6039) Shpenzime tjera operative	5,495,328	12,660,236	3.8
TOTALI	18,028,346	26,536,402	

Në totalin e shpenzimeve për vitin 2015; zërat kryesore ndaj totalit zënë:

- Shpenzimet për lëndë të para e materiale të konsumuara ndaj totalit zënë 11.8 %.Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shëndetësore dhe shoqërore ndaj totalit zënë 49.1 %.



- Shpenzimet për udhëtime e dieta zënë 0,005, %.

B.2. AUDITIM MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT

- Respektimi i procedurave për hartimin dhe miratimin e buxhetit

Projekt buxhetet janë hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZN-it, Tiranë sipas kërkesave të dërguara nga Drejtoria Rajonale të ALUIZNI-t Kukës, dhe janë miratuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit brenda afateve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave.

- Ndarja e plan buxheteve dhe detajimet në nivel titulli, kapitulli, artikull dhe nënartikulli dhe respektimi i disiplinës buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.

- Miratimi i plan buxhetit për vitin 2015.

Buxheti i vitit 2015 për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës është mbështetur në Ligjin nr.160/2014, datë 27.11.2014 " Për buxhetin e vitit 2015", VKM nr.11, datë 14.01.2015 " Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme", të ndryshuar me VKM nr.136, datë 18.02.2015 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 " Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ", udhëzimit nr.2, datë 09.01.2015 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015" të ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave nr.18082/107 prot, datë 09.01.2015, shkresës nr.18082/172 prot, datë 14.01.2015, shkresës së Ministrisë së Financave nr.18083/71 prot, datë 28.01.2015, shkresës nr.6557/1 prot, datë 22.12.2015 të MZHU-së.

Nga auditimi i kryer Për buxhetin e vitit 2015, u konstatua se Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit me shkresat me nr.5476/6 prot, datë 13.01.2015 ka dërguar detajimin e shpenzimeve korente të buxhetit për vitin 2015, shkresën nr.267/1 prot, datë 22.01.2015 lidhur me detajimin e limit mujor të buxhetit për vitin 2015. Ministria e Financave me shkresën nr.18083/6 prot, datë 26.01.2015 i është drejtuar MZHU-së lidhur me detajimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2015. Ministria e Financave me shkresën nr.17201/47 prot, datë 28.12.2015 i është drejtuar MZHU-së lidhur me zbatimin e Aktit Normativ nr.2, datë 11.12.2015. MZHU nga ana e saj me shkresën nr.6557/4 prot, datë 30.12.2015 i është drejtuar ALUIZNI-t lidhur me miratimin e detajimit të fondeve, në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 11.12.2015.

-Miratimi i plan buxhetit për vitin 2016.

Buxheti i vitit 2016 për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës është mbështetur në Ligjin nr.147, datë 17.12.2015 " Për buxhetin e vitit 2016", udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 " Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ", udhëzimit të MF nr.103 prot, datë 07.01.2015, shkresës së Ministrisë së Financave nr.17761/83 prot, datë 14.01.2015, shkresës së Ministrisë së Financave nr.692/1 prot, datë 26.01.2016, udhëzimit plotësues nr.1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016", shkresës nr.279/1, datë 18.01.2016 të MZHU-së, shkresës së MZHU nr.699/1 prot, datë 05.02.2016, shkresës nr.1899/2 prot, datë 16.02.2016 të Ministrisë së Financave, shkresës nr.7928/1 prot, datë 15.06.2016 të Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave me shkresën nr.606/1 prot, datë 15.01.2016 ka dërguar udhëzimin plotësues nr.1 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".

MZHU me shkresën nr.4306/1 prot, datë 24.05.2016 ju është drejtuar drejtorive rajonale lidhur me ndryshimin në udhëzimin plotësues të Ministrit të Financave " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016 ", konkretisht udhëzimi nr.1/4, datë 03.05.2016.

MZHU i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës me shkresën nr.244/1 prot, datë 14.01.2015 lidhur me detajimin e shpenzimeve korente të buxhetit për vitin 2016. MZHU me shkresën nr.86/1 prot, datë 11.01.2016 i është drejtuar ALUIZNI-t Qendror lidhur me detajimin e shpenzimeve korente të buxhetit për vitin 2016. MZHU me shkresën nr.230/1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

prot,datë 18.01.2016 i është drejtuar ALUIZNI-t lidhur me detajimin e limitit mujor të shpenzimeve korente të buxhetit për vitin 2016.

Me shkresën nr.6265 prot,datë 25.08.2016 MZHU i është drejtuar Ministrisë së Financave lidhur me transferimin e pjesës takuese të të ardhurave të arkëtuara nga transferimi i pronës së parcelës ndërtimore për periudhën 01.07.2016-31.07.2016 të Drejtorive të ALUIZNI-t.

-Miratimi i plan buxhetit për vitin 2017

Buxheti i vitit 2017 për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës është mbështetur në Ligjin nr.130,datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", VKM nr.7, datë 11.01.2017 " Për punonjësit me kontratë të përkohshme ", për vitin 2017, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2,datë 06.02.2012 " Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ", shkresës nr.17911/90 prot,datë 12.01.2017, shkresave të Ministrisë së Financave nr.17911/159 prot, dhe nr.17911/165 prot,datë 12.01.2017, udhëzimit nr.8,datë 13.01.2017 të Ministrisë së Financave " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017"

MZHU me shkresën nr.365/1 prot,datë 23.01.2017 i është drejtuar Drejtorive Rajonale të ALUIZNI-t lidhur me detajimin e shpenzimeve korente të buxhetit, për vitin 2017.

MZHU me shkresë nr.205/2 prot,datë 17.01.2017 i është drejtuar ALUIZNI-t Qendror lidhur me detajimin e shpenzimeve korente të buxhetit për vitin 2017.

Me shkresën nr.549/1 prot,datë 07.02.2017 prej MZHU-së është dërguar limiti mujor i buxhetit për vitin 2017, pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës.

Me shkresën nr.205/6 prot,datë 24.01.2017 MZHU ka dërguar pranë ALUIZNI-t detajimin mujor të buxhetit për vitin 2017.

Ministria e Financës me shkresën nr.3613/1 prot,datë 07.04.2017 i është drejtuar MZHU lidhur me rialokimin e shpenzimeve kapitale për ALUIZNI-n.

Ministria e Financës nëpërmjet shkresave nr.10919/1 prot,datë 09.08.2017, nr.4208/3 prot,datë 10.08.2017, 10919/1prot,datë 09.08.2017 i ka miratuar MZHU-së transferimin e fondeve për vitin 2017.

Ministria e Financave me shkresën nr.10919/1 prot,datë 09.08.2017 i është drejtuar MZHU në lidhje me transferimin e fondeve për vitin 2017.

MZHU me shkresën nr.4446/1prot,datë 24.08.2017 i është drejtuar ALUIZNI-t Qendror lidhur me detajimin e Aktit Normativ nr.2,datë 16.08.2017 për shpenzimet korente.

MZHU me shkresën nr.4208/3 prot,datë 10.08.2017 i ka miratuar ALUIZNI-t transferimin e fondeve.

Ministria e Drejtësisë nëpërmjet shkresës nr.8290/1 prot,datë 08.11.2017 ju ka dërguar Drejtorive Rajonale të ALUIZNI-t miratimin e buxhetit dhe limitit për vitin 2017.

-Miratimi i plan buxhetit për vitin 2018

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr.1195prot,datë 13.02.2018 i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës lidhur me detajimin e buxhetit për vitet 2018,2019,2020 për shpenzimet korente dhe miratimi i limitit mujor për vitin 2018.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr.1317/1 prot,datë 06.02.2018 i është drejtuar ALUIZNI-t Qendror në lidhje me detajimin e buxhetit për vitet 2018,2019 dhe 2020 për shpenzimet korente.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.19433/126 prot,datë 24.01.2018 lidhur me detajimin e fondeve buxhetore për shpenzimet korente.

Për sa i përket limitit mujor të vitit 2018 Ministria e Drejtësisë i është drejtuar ALUIZNI-t me shkresën nr.10/3 prot,datë 06.03.2018.

Në vitet 2015 2016, 2017, 2018 (4 mujori), programimi i shpenzimeve është bërë në nivel, titulli, kapitulli dhe artikulli e nën artikulli.

Ndryshimet gjatë vitit për shtesa e pikësime sipas artikujve janë kryer me shkresa të posaçme të MZHUT.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Për vitin 2015, Ministria e Financave i është drejtuar MZHU-së lidhur me limitin mujor 2015 Me shkresën nr.18083/71 prot,datë 28.01.2015, ku i miraton shtesat dhe pakësimet në zërin Shpenzime për Paga 6009999 dhe Shpenzime Operative 6029999. MZHU nga ana e saj me shkresën nr.296/2 prot,datë 02.02.2015 i është drejtuar ALUIZNI-t lidhur me ndryshimin e limitit mujor për vitin 2015 për shtesat dhe pakësimet.

Nga auditimi i kryer në lidhje me detajimin e numrit të punonjësve me kontratë për vitin 2015 rezultoi se Ministria e Financës nëpërmjet shkresës nr.18083/prot, datë 26.01.2015 i është drejtuar MZHU-së në lidhje me detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshëm nga ana e saj, MZHU nga ana e saj i është drejtuar zyrtarisht ALUIZNI-t me shkresat nr.306/1 prot, datë 21.01.2015 dhe nr.687/1 prot,datë 30.01.2015, lidhur me detajimin e numrit të punojësve me kontratë të përkohëshme.

Për vitin 2016, MZHU me shkresën nr.279/3 prot,datë 28.01.2016 i është drejtuar ALUIZNI-t Qendror lidhur me ndryshimin e limitit mujor për vitin 2016, për shtesat dhe pakësimet.

Ministria e Financave i është drejtuar MZHU-së dhe Degës së Thesarit, me shkresën nr.692/1 prot,datë 26.01.2016 lidhur me miratimin e limitit mujor për shtesat dhe pakësimet për shpenzime personeli 6,009,999.

Ministria e Financave, me shkresën nr.1899/1 prot,datë 11.02.2016 i është drejtuar MZHU-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit lidhur me transferimin për shpenzimet korrente të vitit 2016, për përballimin e shpenzimeve të personelit të punonjësve me kontratë

MZHU me shkresën nr.699/4 prot,datë 18.02.2016 i është drejtuar ALUIZNI-t lidhur me ndryshimin e limitit mujor për vitin 2016 për shtesat dhe pakësimet.

Ministria e Financave i është drejtuar MZHU-së me shkresat nr.7928/1prot,datë 15.06.2016 dhe nr.7928/2 prot,datë 17.06.2016 lidhur me miratimin për rialokimin e fondeve për investime, shtesat dhe pakësimet në zërin shpenzime kapitale 2,319,999.

Nga auditimi i kryer në lidhje me detajimin e numrit të punonjësve me kontratë për vitin 2016 Ministrisa e Financave ka miratuar, me shkresën nr.18154/44 prot,datë 12.02.2016 detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016, mbështetur edhe në VKM nr.23,datë 20.01.2016 Për punonjësit me kontratë të përkohshme, për vitin 2016, shkresës së MZHU-së nr.663,datë 02.02.2016, me VKM nr.279,datë 13.04.2016 janë miratuar ndryshimet për punonjësit me kontratë në ALUIZNI-n Kukës për vitin 2016 dhe konkretisht 1 specialist i lartë dhe 1 specialist i mesëm, faktuar edhe me shkresën nr.2086/1 prot,datë 25.04.2016 të Ministrisë së Financave drejtuar ALUIZNI-t lidhur me detajimin e numrit te punonjësve me kontratë, si dhe shkresës nr.5205/1 prot,datë 29.06.2016 të MZHU-së nga ku kjo ministri i dërgon ALUIZNI-t Kukës miratimin e numrit të punonjësve me kontratë, dhe konkretisht 3 specialist të lartë dhe 1 specialist i mesëm.

Për vitin 2017 ndryshimet ne buxhet janë argumentuar si me poshtë :

MZHU me shkresën nr.1063/2 prot,datë 20.02.2017 i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës lidhur me miratimin e detajimit të numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2017 dhe miratimin e transferimit të fondeve buxhetore,

Me shkresën nr.3613/2 prot,datë 18.04.2017 Ministria e Financës i është drejtuar MZHU lidhur me miratimin e limitit për shtesat dhe pakësimet në zërin shpenzime kapitale

MZHU me shkresën nr.4208/3 prot,datë 14.08.2017 i ka miratuar ALUIZNI-t limitin lidhur me shtesat dhe pakësimet në zërin shpenzime personeli dhe shpenzime operative.

Me shkresën nr.10919/2 prot,datë 11.08.2017 Ministria e Financave i është drejtuar MZHU-së lidhur me miratimin e limitit për shtesat dhe pakësimet për shpenzime personeli dhe ato operative

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.11721/82prot,datë 23.10.2017 i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me autorizimin për shtesat në zërin Shpenzime Personeli.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.1153/1 prot, datë 01.11.2017 i është drejtuar ALUIZNI-t lidhur me miratimin e buxhetit për shtesat dhe pakësimet në zërin 6,009,999.

MZHU me shkresën nr.557/5 prot, datë 09.02.2017 ka dërguar miratimin e numrit të punonjësve me kontratë për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës, organikë e përbërë nga 6 specialist drejtorie rajonale, 2 teknik të mesëm dhe 1 sanitare, si dhe me shkresën nr.1063/1 prot, datë 17.02.2017. MZHU ka miratuar transferimin e fondeve buxhetore me shkresën nr.557/4 prot, datë 09.02.2017 për përballimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për punonjës të kontratë të përkohshme për vitin 2017. Gjithashtu MZHU me shkresën nr.1063/2 prot, datë 20.02.2017 ju është drejtuar degëve përkatëse të thesarit nga ku ju paraqet miratimin e listës për punonjës të kontratë, njëkohësisht me shkresat nr.2183/3 prot, datë 03.05.2017, nr.2807/1 prot, datë 24.05.2017 drejtorive rajonale ju është miratuar detajimin i numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme.

Për vitin 2018, me shkresën nr.17911/1 prot, datë 20.02.2018 Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është drejtuar degës së thesarit si dhe Ministrisë së Drejtësisë lidhur me detajimin e punonjësve me kontratë, në zbatim të VKM nr.60, datë 13.01.2018 Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qëndrore, organikë e përbërë nga 1 Specialistë, 2 teknik të mesëm dhe 2 sanitare

Me shkresën nr.2927/1 prot, datë 17.04.2018 të Ministrisë së Drejtësisë, ALUIZNI-t Kukës i është transferuar fondi për vitin 2018 lidhur me pagesën e pagave të punonjësve me kontratë Të dhënat në pasqyrat e shpenzimeve të bilanceve kontabël, janë të njëjta me situacionet progresive të shpenzimeve të rakorduar me Degën e Thesarit Tirane

Financimi nga buxheti i shtetit është bërë në varësi të realizimit të ardhurave të brendshme të realizuara gjatë vitit nga Drejtoria ALUIZNI-t Kukës.

Të ardhurat janë në mbështetje të ligjit nr. 9895, datë 09.06.2008, VKM nr. 1180, datë 05.08.2008, Udhëzimit nr. 37, datë 20.11.2008, Vendimi i KM nr. 1147 datë 05.08.2008, Vendimi i KM nr. 515 datë 13.05.2009 dhe Vendimi i KM nr. 246, datë 13.04.2010.

- Rregullshmëria e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit për shpenzimet e të ardhurat nga kryerja e legalizimeve.

Për akordimin e fondeve nga të ardhurat e pagesës për legalizimin e ndërtimeve pa leje të përcaktuar në aktet ligjore përkatëse, për vitin 2015-2017, Drejtoria e ALUIZNI-t Kukës, ka kryer rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit me shuma përkatëse të detajuara.

Të ardhurat në cash, për llogari të ALUIZNI-t Kukës janë arkëtuar në bankat e nivelit të dytë, Credins Bank, BKT dhe Tirana Bank duke rakorduar për çdo muaj dhe në mbyllje të çdo periudhe ushtrimore me Degën e Thesarit Tirane

- Përdorimi efektiv i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Analizë e detajuar plan fakt. përqindja për periudha të njëjta kohe, për investimet, pagat, shpenzimet korrent, etj. Nxjerrja e përgjegjësiave për deviacionet.

Zbatimi i buxhetit sipas artikujve.

Për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës

000 lek

Nr. llog	Emërtimi i shpenzimit	VITI 2015			VITI 2016			Viti 2017			30.04.2018		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
600	Paga	7.565	7.363	97	8.470	8.315	98	9.236	7.642	83	2.750	1.942	71
601	Sig. shoqërore	1.252	1.201	96	1.415	1.415	100	1.807	1.269	70	385	324	84
602	Shp.operative	2.619	2.619	100	2.244	2.244	100	2.199	2.199	100	800	646	81
606	Shpenz. tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
231	Investime	480	467	97	240	233	97	960	954	99	0	0	0
	TOTALI	11960	11650	97	12369	12207	99	14202	12064	85	3935	2912	74



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Fondet e çelura nga Dega e Thesarit, janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse për të cilat nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim artikujsh dhe tejkalim limitesh. Janë përpiluar dhe nënshkruar rakordimet për të ardhurat. Nga krahasimi i buxheteve për të tre vitet rezulton që fondet nga viti në vit në dispozicion të këtij institucioni janë në ulje si nga planifikimi dhe nga realizimi.

Ndryshimet përkatëse janë autorizuar si shtesa duke pasqyruar një rritje të dhe pakësim për paga sipas shkresave të Ministrisë së Financave të trajtuara më lart. Njëherësh me pagat janë likuiduar edhe shpenzimet për sigurimet shoqërore shëndetësore dhe tatimi mbi pagat.

Për 3 vitet, ka pasur ndryshime në shtesa e pakësim të urdhëruara nga Ministria e Zhvillimit Urban, të miratuara nga Ministria e Financave, kryesisht për efekt të ndryshimit të pagave, organizimit të zyrave të ALUIZNI-t në qarqe etj.

Realizimi i **shpenzimeve operative** është dokumentuar sipas nënartikujve të llogarisë nr. 602, "Shpenzime operative" paraqitet:

Për ALUIZNI-n Kukës

000 lek

Nr	E m ë r t i m i	2015		2016		2017		30.04.2018	
		Pl	Fakt	Pl	Fakt	Pl	Fakt	Pl	Fakt
1	Karburant, vaj	378	378	380	380	400	400	400	x
2	Kancelari	308	308	150	100	170	100	120	111
3	Mat.pastr.diseft	250	250	150	149	102	72	114	94
4	Mat.fum\k,pajisje,zyre	100	98	100	100	102	96	114	x
5	M. furnz.tjera,pergjithshme	170	100	150	100	150	93	120	x
6	Pjesë këmb, goma, bateri	x	x	x	x	x	x	x	x
7	Sh.sigurim mjeti transporti	x	x	x	x	x	x	x	x
8	Shp.mirmb.objekt. Ndert	170	170	270	264	200	199	200	x
9	Shp. Mirmb pajisje Zyre	103	100	102	100	102	60	114	x
10	Shp. Tjera materia. e sherbi	170	99	150	100	102	93	114	x
11	Shpen. Ruajtje objekti(479)	x	x	x	x	x	x	x	x
12	Shp.energj,telefon,postare	x	x	x	x	x	x	x	x
-	Elektriku (vjetore)	x	x	x	x	x	x	x	x
-	-Telefoni (vjetore)	x	36	x	36	x	36	x	12
-	Postare (vjetore)	x	93	x	85	x	133	x	45
13	Shpenzime Gjyqësore	x	45	x	x	x	x	x	x
14	Shpenzime Uji	x	18	x	20	x	25	x	x
15	Shpenzime printimi	193	114	102	100	102	102	114	95
16	shpenzime qera	x	x	x	x	x	x	x	x
17	Blerje formulare e dok tjera	42	42	100	100	102	92	114	95
18	shpenzime udhëtim e dieta	x	768	x	591	x	489	x	175
19	Taksë vendore Bashkia Kukës	x	x	x	20	x	20	x	20
20	Shpenzime për ngrohje	x	x	x	x	80	80	72	x
21	Shpenzime për aktivitete sociale (Shërbime fonie për event)	x	x	x	x			x	x
						108	108		

Nga krahasimi i kryer për periudhën objekt auditimi lidhur me llogarinë 602 "shpenzime operative" sipas të dhënave në tabelën e mësipërme rezulton se shpenzimet operative në nivel artikulli dhe në nivel nënartikujsh kanë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel realizimi.

- Rakordimet me Degën e Thesarit për arkëtimet nga legalizimet.

U bë krahasimi i pasqyrave të bilanceve për të ardhurat dhe shpenzimet me aktrakordimet dhe nuk u konstatuan deviacione.

Specialistët e ALUIZNI-t Kukës plotësojnë formularët e tarifës së Shërbimit, parcelës ndërtimore, sanksione për vonesa në vetëdeklarim, penalitete shtesa të ndryshme dhe hartohet faturë arkëtimi dhe shpërndahet në personat që kanë bërë vetëdeklarim. Pagesa realizohet nëpërmjet bankave, konfirmimi i derdhjeve bëhet nëpërmjet Degës së Thesarit Tirane si dhe regjistrimi i faturave të derdhura në regjistrin paraprak elektronik të hapur për këtë qëllim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Sipas të dhënave të paraqitura nga evidence e të ardhurave në lekë, të rakorduar me Degën e Thesarit, rezulton se realizimi i të ardhurave për vitin 2015, 2016 dhe 9-mujorin e vitit 2017 paraqitet si më poshtë:

Më poshtë po paraqesim tabelën mbi të ardhurat: 000/lekë

Nr	Vitet	ALUIZNI	Tarifë shërbimi	Të ardhura				
				Penalitete	Parcela	TNI	E ardhur tjetër	Gjithsej
1	Viti 2015	Kukës	1.180	215	24.284		55	25.734
2	Viti 2016	Kukës	424	20	14.125		x	14.569
3	Viti 2017	Kukës	352	55	6.608		19	7.034
4	30.04.2018	Kukës	216	28	4.145		x	4.390
	Totali		2.172	318	49.162		74	51.727

Nga Drejtoria ALUIZNI-t Kukës janë kryer shpenzime me çelje fondesh nga buxheti i shtetit edhe nga të ardhurat e realizuara nga tarifa e shërbimit dhe sanksionet për vonesat në vet deklarim.

Mbi bazën e të dhënave të ALUIZNI-t është rakorduar me degën e thesarit të rrethit për çdo muaj, mbështetur në udhëzimet respektive të Ministrisë Financave për zbatimin e buxheteve të viteve ushtrimore.

Rakordimet janë përpiluar dhe nënshkruar nga të dy palët në mënyrë progresive.

Shpenzimet e ALUIZNI-t Kukës sipas burimeve financiare, në 000/lekë

Nr	Vitet	Shpenzime	Nga buxheti	Nga të	Të tjera
	buxhetore	gjithsej	i shtetit	ardhurat	kthim parcele
1	Viti 2015	11.650	10.811	839	-
2	Viti 2016	12.207	11.118	1.089	-
3	Viti 2017	12.063	11.064	999	-
4	30.04.2018	2.913	2.829	84	-
	TOTALI	38.833	35.822	3.011	-

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kukës gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk ka patur vështirësi financiare, ka përballuar normalisht nevojat për shpenzime dhe siguruar mjete të lira likuiditeti, të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit.

B.3. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (pagat dhe shpërblimet etj)

Mbi Organizimin dhe Funksionimin dhe funksionimin e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Kukës.

Në bazë të ligjit të Shërbimit Civil dhe të dispozitave të ligjit për pagat e punonjësve Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit, zbatimin e dispozitave ligjore të pagave, kontabilizimin e shërbimeve etj. dhe organizimin e procedurave të rekrutimit të stafit të ri, për përgatitjen e procedurave të punësimit, për menaxhimin e trajnimeve etj.

Urdhrit nr.111, datë 06.08.2015 të Kryeministrit "Miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe Drejtoritë në varësi të saj. Dërgohet VKM nr.135, datë 15.04.2015 për ndryshimin e VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Miratimi i strukturës dhe nivelit të pagave .. 4 sipas lidhjes 9/4 që sipas së cilës përcaktohet kategoria III-a/1 me grupin 1 Drejtor, IV-a – grupi 1 dhe IV-b grupi 1, ose 2 ose 3 duke përcaktuar dhe kushtet e punës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

STRUKTURA: Drejtor , sektori i Legalizimit Planifikimit Urban Kukës, sektori i Legalizimit Pogradec ,sektori i Hartografisë Përpunimit Informacionit, sektori i Çështjeve të Pronësisë, dhe sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse .

Referuar urdhrorit nr.111,datë 06.08.2015 të Kryeministrit Për Miratimin e Strukturës dhe të Organizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Informale dhe Drejtorive në Varësi të Saj, shkresës nr.6974/3 prot,datë 23.01.2017 të MZHU, ORGANIKA **për vitin 2015** përbëhet nga 8 punonjës nga të cilët :

- Drejtor 1
- Përgjegjës Legalizimi Kukës 1
- Përgjegjës i Hartografisë & GIS 1
- Përgjegjës i Sektorit të Financës 1
- Specialistë 3
- Arkiv-Protokoll 1

Për nëpunësit e Drejtorisë ALUIZNI-t Kukës zbatohet procedura e Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" me ndryshime me VKM nr.11 datë 14.01.2015 të Këshillit të ministrave "Për përcaktimin e punonjësve me kontratë"

Si dhe në zbatim të zbatimit të ligjit të Buxhetit nr. 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 , "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ", shkresës së Ministrisë së Financave nr.18082/107 prot, datë 09.01.2015, shkresës së Ministrisë së Financave nr.18082/172 prot, datë 14.01.2015, shkresës nr.5476/6 prot,datë 13.01.2015 të MZHU-së, shkresës nr.267/1 prot,datë 22.01.2015 të MZHU-së, shkresës nr.18083/prot, datë 26.01.2015 të Ministrisë së Financave, VKM nr.136, datë 18.02.2015, Për disa ndryshime në VKM nr. 11, datë 14.01.2015 "Për punonjësit me kontratë" .

- Specialistë me kontratë të përkohshëm 1
- Teknik të Mesëm 1
- Sanitare 1

Nga auditimi i kryer në lidhje me detajimin e numrit të punonjësve me kontratë për vitin 2015 rezultoi se Ministria e Financës nëpërmjet shkresës nr.18083/prot, datë 26.01.2015 i është drejtuar MZHU-së në lidhje me detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme nga ana e saj, MZHU i është drejtuar zyrtarisht me shkresën nr.687/1 prot,datë 30.01.2015, Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, për detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme.

Struktura viti 2016

Nga auditimi i kryer rezultoi se për vitin 2016 MZHU me shkresën nr.944/1 prot,datë 09.02.2016 ka miratuar detajimin e numrit të punonjësve për vitin buxhetor 2016, në përputhje me urdhrin nr. 58,datë 05.04.2016 të Kryeministrit i cili ka miratuar strukturën dhe organizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t dhe Drejtorive në varësi të saj, gjithashtu MZHU me shkresën nr.4064/1 prot,datë 18.05.2016 i është drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t Kukës lidhur me detajimin e numrit të punonjësve, normativë e konfirmuar edhe prej shkresës nr.2487/1 prot,datë 24.05.2016, si dhe në zbatim të Ligjit nr.147/2015 Për buxhetin e vitit 2016, VKM nr.117,datë 17.02.2016 Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2016, shkresës nr.5341/1, datë 27.04.2016 të Ministrisë së Financave, nga ku pasqyrohet struktura përkatëse e ALUIZNI-t Kukës e përbërë nga:

- Drejtor 1
- Sektori i legalizimit dhe planifikimit urban 3
- Sektori i hartografisë përpunimit të informacionit dhe çështjeve të pronësisë 2
- Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse 2

Punonjësit me kontratë viti 2016

Për vitin 2016 Me shkresën nr.18154/44 prot,datë 12.02.2016 Ministria e Financave ka miratuar detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

mbështetur edhe në VKM nr.23, datë 20.01.2016 Për punonjësit me kontratë të përkohshme, për vitin 2016, shkresës së MZHU-së nr.663, datë 02.02.2016, nga ku rezultoi se për vitin 2016 janë lidhur marrëdhënie kontraktuale me punonjës të përkohshëm si më poshtë:

- | | |
|------------------------|---|
| • Specialistë të lartë | 2 |
| • Teknik të Mesëm | 1 |
| • Sanitare | 1 |

Rezultoi se me VKM nr.279, datë 13.04.2016 janë miratuar ndryshimet për punonjësit me kontratë në ALUIZNI-n Kukës për vitin 2016 dhe konkretisht 1 specialist i lartë dhe 1 specialist i mesëm, faktuar edhe me shkresën nr.2086/1 prot, datë 25.04.2016 të Ministrisë së Financave drejtuar ALUIZNI-t lidhur me detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, si dhe shkresës nr.5205/1 prot, datë 29.06.2016 të KZHU-së nga ku kjo ministri i dërgon ALUIZNI-t Kukës miratimin e numrit të punonjësve me kontratë dhe konkretisht 3 specialist të lartë dhe 1 specialist i mesëm.

Struktura 2017

MZHU me shkresën nr.6974/3 prot, datë 24.01.2017 i ka dërguar ALUIZNI-t qendror dhe drejtorive në varësi të saj detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2017 dhe konkretisht organika për ALUIZNI-n Kukës do të jetë e njëjtë me atë të vit paraardhës, e përbërë nga:

- | | |
|---|---|
| Drejtor | 1 |
| • Sektori i legalizimit dhe planifikimit urban | 3 |
| • Sektori i hartografisë përpunimit të informacionit dhe çështjeve të pronësisë | 2 |
| • Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse | 2 |

Punonjësit me kontratë 2017

MZHU me shkresën nr.557/5 prot, datë 09.02.2017 ka dërguar miratimin e numrit të punonjësve me kontratë për Drejtorinë e ALUIZNI-t Kukës, organikë e përbërë nga 6 specialiste drejtorie rajonale, 2 teknik të mesëm dhe 1 sanitare, si dhe me shkresën nr.1063/1 prot, datë 17.02.2017. MZHU ka miratuar transferimin e fondeve buxhetore me shkresën nr.557/4 prot, datë 09.02.2017 për përballimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2017. Gjithashtu MZHU me shkresën nr.1063/2 prot, datë 20.02.2017 ju është drejtuar degëve përkatëse të thesarit nga ku ju paraqet miratimin e listës për punonjësit me kontratë, njëkohësisht me shkresat nr.2183/3 prot, datë 03.05.2017, nr.2807/1 prot, datë 24.05.2017 drejtorive rajonale ju është miratuar detajimin i numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme në *përputhje me Ligjin 130/2016, datë 15.12.2016 Për buxhetin e vitit 2017, VKM nr.251, datë 29.03.2017, të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.8, datë 11.01.2017 Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2017, shkresave me nr.17683/104 prot, dhe nr.17683/105 prot, datë 07.02.2017*

Struktura viti 2018

Nga auditimi i kryer në dokumentacion e vënë në dispozicion prej ALUIZNI-t Kukës për vitin 2018 rezultoi se Drejtoria e ALUIZNI-t Qendror ju është drejtuar drejtorive rajonale përkatëse lidhur me detajimin e buxhetit për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në zbatim të Ligjit nr.109/2017 Për buxhetin e vitit 2018, dhe shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.19433/126 prot, datë 24.01.2018 dhe nr.19433/142 prot, datë 29.01.2018, faktuar edhe me shkresë nr.1737/1 prot, datë 12.03.2018 të Ministrisë së Drejtësisë drejtuar ALUIZNI-t lidhur me detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2018, organikë e përbërë nga :

- | | |
|---|---|
| Drejtor | 1 |
| • Sektori i legalizimit dhe planifikimit urban | 3 |
| • Sektori i hartografisë përpunimit të informacionit dhe çështjeve të pronësisë | 2 |
| • Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse | 2 |

Punonjësit me kontratë viti 2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Me shkresën nr.17911/1 prot,datë 20.02.2018 Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është drejtuar degës së thesarit si dhe Ministrisë së Drejtësisë lidhur me detajimin e punonjësve me kontratë, në zbatim të VKM nr.60,datë 13.01.2018 Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore, organikë e përbërë nga 1 Specialistë, 2 teknik të mesëm dhe 2 sanitare.

Krahasimi i përmbledhësës së listë pagesave me shumat e urdhër shpenzimeve dhe pagesat e kryera.

Realizimi i fondit të pagave 000/lekë													
Nr	Emërtimi	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017			30.04.2018		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Paga	7.565	7.363	97	8.470	8.315	98	9.236	7.642	83	2.750	1.942	71
2	Sig. shoqërore	1.252	1.201	96	1.415	1.415	100	1.807	1.269	70	385	324	84
3	Nr. Punonjësve	12	12	100	18	14	78	18	12	67	12	11	92

Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës si listë prezencat, urdhrat e veçantë të titullarit. Janë nënshkruar nga drejtuesi kryesor të gjithë listë prezencat dhe urdhër shpenzimet për paga. Urdhër shpenzimet janë nënshkruar edhe nga dega e Thesarit Kukës.

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma, fatkeqësi etj.

Hapja dhe azhurnimi periodik i regjistrin të punëmarrësve (libri i pagave).

Veprimet e kryera në regjistrin themeltar janë mbështetur në urdhrat e Drejtorit, mbështetur në kontratat dhe për ndërprerjet e marrëdhënieve financiare, mbështetur në VKM nr. 355, datë 07.07.2000." Për organizimin e dosjes së personelit".

U bë krahasimi i librit të pagave me regjistrin themeltar sipas viteve, për rakordimin e numrit të nëpunësve të paguar me atë të përfshirë në regjister dhe nuk pati parregullsi.

U bënë verifikime me zgjedhje për regjistrimin e nëpunësve me kontratë dhe rezultoi se janë të regjistruar në regjistrin themeltar dhe në librin e pagave, veprime të rakorduara me të dhënat e listë - pagesave.

Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të VKM nr. 589, datë 17.7.2013 "Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil, zv/ministrit dhe nëpunësit të kabineteve në Kryeministri, aparatit e ministrive të linjës, administratës të presidentit, komisionit qendror të zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit" lidhja 1 Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi" dhe lidhja nr. 9/4 "Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në drejtoritë e agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integritetit të zonave/ndërtimeve informale".

Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave për vitin 2015, 2016 ,2017 dhe vitin 2018 (4 mujori) në lidhje me verifikimin e nivelit të pagave për çdo punonjës dhe arsimimin sipas diplomës, vjetërsinë e punës të përcaktuar në librezat e punës të secilit nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit, për rrjedhojë rezultoi se ato janë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit Ministrave.

Në përlogaritjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë të përballuara nga punëmarrësi dhe ato të përballuara nga punëdhënësi, deklaratimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 7770, datë 13.10.1994 "Për sigurimet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

Regjistri i nëpunësve është mbajtur dhe azhurnuar periodikisht sipas nëpunësve. Janë mbajtur dosjet e punonjësve ku janë të kompletuar me dokumentacionin e duhur.

Niveli pagave për punonjësit më kontratë të përkohshme është përcaktuar në kategorinë IV-b sipas VKM nr. 589, datë 17.7.2013 "Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civil, zv/ministrit dhe nëpunësit të kabineteve në Kryeministri, aparatit e ministrive të linjës, administratës të presidentit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurime së përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucione në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit", ndërsa për specialistët e mesëm niveli i pagës është përcaktuar sipas kategorisë VI të Lidhjes II të VKM nr. 610 datë 24.07.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore" pika 1/b.

Për gjithë punonjësit me kontratë janë hapur dosje me të dhënat e domosdoshme për arsimin, kualifikimet, CV, certifikatat personale, librezat e punës, kontratat e lidhura me punëdhënësin e shkresat e emërimit sipas periudhave si dhe dokumentet e tjera plotësuese të dosjes në përputhje me kërkesat e VKM nr. 355, datë 07.07.2000." për organizimin e dosjes së personeli".

Kontratat janë lidhur në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë "i ndryshuar.

Me urdhër nr. 117, datë 14.7.2015 të Ministrit të Zhvillimit Urban është bërë miratimi i Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e ALUIZNI-t", e cila ka shfuqizuar rregulloren e Brendshme me nr. 61, datë 16.01.2008.

Marrja në punë dhe përcaktimi i pozicionit dhe nivelit të pagës të punonjësve si me kontratë më kohë të pacaktuar dhe me kontratë të përkohshme është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t.

B.4. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime

Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Kukës, për periudhën objekt auditimi kanë kryer shpenzime me vlerë të vogël, kryesisht për materiale kancelarie, shërbim interneti, mirëmbajtje etj, ku shumica e shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës, konkretisht sipas auditimit me zgjedhje u konstatua:

Urdhër shpenzimit nr.26, datë 24.02.2015, kancelari në shumën 86,500 lekë, për llogari të G., P. E.. Disponohet urdhër prokurimi nr.3, datë 09.02.2015, tre ofertat nga OE, faturë e thjeshtë tatimore nr.85, datë 12.02.2015, fletë hyrje nr.1, datë 12.02.2015, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë, datë 10.02.2015.

Urdhër shpenzimi nr.27, datë 26.02.2015, likuidim I pjesshëm I karburantit, K. shpk, në shumën 75,767 lekë. Disponohet faturë me TVSH nr.8, datë 23.02.2015 për sasinë 450 lit, kontratë nr.1, datë 20.02.2015 lidhur midis titullarit të ALUIZNI-t Kukës dhe Subjektit K. sh.p.k, formular I ofertës datë 17.02.2015, ekstrakt nga QKR, urdhër prokurimi nr.1, datë 05.02.2015 me fond limit 233,333 lekë, ftesë për ofertë, procesverbal nr.1, datë 18.02.2015 për shpalljen fitues të OE A.K.F Petroleum, procesverbal nr.2, datë 19.02.2015 për mos paraqitjen e OE shpallur fitues I pari, procesverbal nr.3, datë 20.02.2015 për shpalljen fitues të OE renditur I dyti K. sh.p.k



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Urdhër Shpenzimin nr.48, datë 01.04.2015, likuidim I pjesshëm I karburantit, K. sh.p.k në shumën 103,086lekë. Disponohet faturë me TVSH nr.45, datë 05.03.2015 për sasinë prej 1190lit, fletë hyrje nr.4, datë 09.03.2015

Urdhër Shpenzimi nr.60, datë 15.04.2015, material pastrimi ngrohje, në shumën 94,200lekë, për llogari të G. P. E., urdhër prokurimi nr.4, datë 08.04.2015, 3 oferta nga OE, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, faturë e thjeshtë tatimore nr.1, datë 14.04.2015, fletë hyrje nr.5, datë 14.04.2015

Urdhër Shpenzimi nr.67, datë 04.05.2015, likuidim total I faturës nr.45, në shumën 100,000lekë për llogari K. sh.p.k

Urdhër Shpenzimi nr.48, datë 01.04.2015 likuidimi pjesor I faturës nr.45, datë 05.03.2015 në shumën 103,086(do par prap karburanti)

Urdhër Shpenzimin nr.78, datë 25.05.2015, furnizim material(kancelari) në shumën 92,500lekë, për llogari të G. P. E.. Urdhër Prokurimi nr.5, datë 20.05.2015, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, së bashku me 3 ofertat nga OE, faturë e thjeshtë tatimore nr.6, datë 21.05.2015, fletë hyrje nr.6, datë 21.05.2015. Nga auditimi rezultoi se me urdhrin e prokurimit të sipërcituar do të prokurohen edhe 2 Distancë metër në shumën 42,000 lekë, veprim I cili nuk ka lidhje me objektin e prokurimit pasi nuk janë material kancelarie, ***gjithashtu nuk disponohen specifikime teknike si dhe garancia në lidhje me këta distancë metër***, çka bie ndesh me **Ligjin nr.10296**, datë 08.07.2010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 2, neni 4, pika 19, pika 26, **UMF nr.30**, datë 27.12.2011 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" neni 36*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktuesin e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës....*, **Urdhri nr.33**, datë 11.07.2013 " Për Gjurmët Standarte të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë", ngarkon me përgjegjësi P/Financës znj.N. Sh.

Urdhër Shpenzimi nr.92, datë 16.06.2015, blerje material boje print + shërbime prin publikun, në shumën 83,000lekë, për llogari të G. P. E. Disponohet urdhër prokurimi nr.6, datë 11.06.2015, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë së bashku me ofertat përkatëse nga OE, faturë e thjeshtë tatimore nr.7, datë 15.06.2015, fletë hyrje nr.7, datë 15.06.2015

Urdhër Shpenzimi nr.105, datë 10.07.2015, shpenzime për mirëmbajtje të zyrave në shumën 83,000lekë, për llogari të P. E. Disponohet urdhër prokurimi nr.7, datë 06.07.2015, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë I datës 08.07.2015, ofertat e paraqitura nga OE, faturë e thjeshtë tatimore nr.9, datë 08.07.2015, fletë hyrje nr.9, datë 09.07.2015

Urdhër Shpenzimi nr.122, datë 07.08.2015, materiale pastrimi, në shumën 50,000lekë(pjesor), për llogari të G. dhe pjesa e mbetur është paguar me urdhër shpenzimin nr.123, datë 07.08.2015. Disponohet urdhër prokurimi nr.8, datë 03.08.2015, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, tre ofertat nga operatorët ekonomik , faturë e thjeshtë tatimore nr.10, datë 06.08.2015 në shumën totale 92,000lekë, fletë hyrje nr.10, datë 06.08.2015.

Urdhër Shpenzimi nr.149, datë 07.10.2015, shërbime të tjera, në shumën 99,400lekë(kancelari), për llogari të G. P. E. Urdhër Prokurimi nr.9, datë 10.09.2015, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë dhe 3 ofertat nga OE, faturë e thjeshtë tatimore nr.15, datë 14.09.2015, fletë hyrje nr.11, datë 14.09.2015.

Urdhër Shpenzimi nr.166, datë 23.11.2015, material funksionimi(kancelari), në shumën 19,344lekë për llogari të T. K. Disponohet urdhër prokurimi nr.11, datë 12.11.2015, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë. Faturë me TVSH nr.56, datë 18.11.2015, fletë hyrje nr.13, datë 18.11.2015.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Urdhër Shpenzimi nr.167, datë 23.11.2015, likuidim fature shërbime e mirëmbajtje zyrash, në shumën 166,800lekë, për llogari të M. sh.p.k. Disponohet urdhër prokurimi nr.10, datë 20.10.2015 me fond limit 141,649lekë pa tvsh, ftesë për ofertë me datë zhvillim tenderi 22.10.2015, preventiv, procesverbal nr.1, datë 04.11.2015 për shpalljen fitues të B. M. I renditur I pari, **rezultoi se nuk disponohet formular për njoftimin e fituesit**, procesverbal nr.2, datë 05.11.2015 për shpalljen fitues të OE renditur I dyti D. sh.p.k, pasi OE renditur I pari nuk u paraqit, formular I njoftimit të fituesit I datës 5.11.2015, procesverbal nr.3, datë 06.11.2015 për shpalljen fitues të OE A. D. I renditur I treti si rezultat I mosparaqitjes të OE renditur I dyti, formular I njoftimit të fituesit datë 06.11.2015, procesverbal nr.4, datë 09.11.2015 për shpalljen fitues të OE M./K I renditur I katërti si pasojë e mos paraqitjes së OE renditur I treti, formular I njoftimit të fituesit datë 06.11.2015, procesverbal nr.5, datë 10.11.2015 për shpalljen fitues të OE renditur I katërti, për arsyen e mos marrjes pjesë e OE renditur I treti,, **mungon procesverbali për shpalljen fitues të OE renditur I pesti si dhe formulari I njoftimit të fituesit për OE**, situacion punimesh, licencë me nr.NZ 2832/9, ekstrakt nga QKR, kontratë e datës 10.11.2015 lidhur midis titullarit të institucionit dhe firmës M./K me afat kryerje punimesh brenda 2 ditësh nga data e lidhjes së kontratës. Lidhur me mangësitë e konstatuara mban përgjegjësi P/Financës znj.N. Sh., në kundërshtim me **Ligjin nr.10296**, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 2, neni 4, pika 19, pika 26, **UMF nr.30**, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" neni 36Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës...., **Urdhërin nr.33**, datë 11.07.2013 "Për Gjurmët Standarte të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë".

Urdhër Shpenzimi nr.168, datë 24.11.2015, material funksionimi (kancelari), pjesore, në shumën 28,990lekë, për llogari të G. P. E. Urdhër Prokurimi nr.12, datë 13.11.2015, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, 3 oferta nga OE, faturë e thjeshtë tatimore nr.18, datë 15.11.2015 në shumën 71,190 lekë, fletë hyrje nr.14, datë 18.11.2015 në shumën 54,690 lekë pra me një diferencë prej 16,500lekë(fotokopjo dok me ngjyra),

Urdhër Shpenzimi nr.188, datë 14.12.2015, kancelari, në shumën 207,646lekë (pjesor), për llogari të C. sh.p.k. Disponohet faturë me TVSH nr.117, datë 10.12.2015, fletë hyrje nr.16, datë 10.12.2015, urdhër prokurimi nr.13, datë 25.11.2015, ftesë për ofertë me datë zhvillim tenderi 02.12.2015, formular I njoftimit të fituesit datë 09.12.2015, akt dorëzimi I datës 10.12.2015, ekstrakt nga QKR, deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike

Urdhër Shpenzimi nr.190, datë 16.12.2015, pajisje kompjuterike, në shumën 467,400lekë, për llogari të PC S. sh.p.k. Disponohet urdhër prokurimi nr.14, datë 25.11.2015 me fond limit 400,000lekë, ftesë për ofertë me datë zhvillim tenderi 02.12.2015, specifikimet teknike, formular I njoftimit të fituesit datë 10.12.2015, procesverbal nr.6, datë 11.12.2015 për shpalljen fitues të Pc S, faturë me tvsh nr.4787, datë 11.12.2015, fletë hyrje nr.17, datë 11.12.2015, ekstrakt nga QKR.

Urdhër Shpenzimi nr.63, datë 13.05.2016, blerje karburanti, në shumën 285,000lekë (likuidim pjesor I shumës 439,709lekë, për llogari të K. sh.p.k. Disponohet urdhër prokurimi nr.2, datë 01.04.2016 për karburant 316,667lekë pa TVSH, gaz për ngrohje 50,000lekë, ftesë për ofertë me datë zhvillim tenderi 04.04.2016, procesverbali nr.1, datë 12.04.2016 për përzgjedhjen e ofertuesit, formulari I njoftimit të fituesit datë 12.04.2016, raport përmbledhës datë 13.04.2016, faturë me TVSH nr.31, datë 13.04.2016, fletë hyrje nr.3, datë 13.04.2016

Urdhër Shpenzimi nr.93, datë 13.07.2016, shërbime të ndryshme (riparim kondicioneri), në shumën 42,000lekë për llogari të B. D. Disponohet urdhër prokurimi nr.7, datë 20.06.2016, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, 3 ofertat, faturë e thjeshtë tatimore nr.6, datë 05.07.2016, ekstrakt nga QKR

Urdhër Shpenzimi nr.122, datë 15.09.2016, blerje formularë të ndryshëm, në shumën 97,100lekë për llogari të G. P. E. Disponohet urdhër prokurimi nr.8, datë 05.09.2016, procesverbal I



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë (me fond limit 126,870lekë), faturë e thjeshtë tatimore nr.38, datë 09.09.2016 në shumën totale 123,700lekë, likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr.123, datë 15.09.2016 dhe Urdhër Shpenzimin nr.124, datë 15.09.2016. *Nga auditimi I kryer në regjistrin elektronik të QKR rezultoi se OE G. P. E. me NIPT K87615201H, është I pezulluar që prej datës 29.03.2016*

Urdhër Shpenzimi nr.137, datë 13.10.2016, kancelari në shumën 99,800lekë, për llogari të G. P. E., urdhër shpenzimi nr.138, datë 13.10.2016 në shumën 40,000lekë, urdhër shpenzimi nr.139, datë 13.10.2016, furnizim material të tjera të përgjithshme në shumën 30,500lekë, urdhër shpenzimi nr.140, datë 13.10.2016, blerje formularë të ndryshëm. Disponohet urdhër prokurimi nr.10, datë 05.10.2016, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë dhe fond limit 173,900lekë, 3 ofertat, faturë e thjeshtë tatimore nr.40, datë 10.10.2016 në shumën 173,100lekë, fletë hyrje nr.7, datë 10.10.2016. Nga auditimi I kryer në regjistrin elektronik të QKR rezultoi se OE G. P. E. me NIPT K87615201H, është I pezulluar që prej datës 29.03.2016.

Urdhër Shpenzimi nr.141, datë 17.10.2016, pajisje informatike, në shumën 233,400lekë, për llogari të PC S. sh.p.k. Disponohet urdhër prokurimi nr.9, datë 27.09.2016 nga ku konstatohet se do të prokurohet edhe 2 Distancë metër në shumën 100,000lekë (high precision laser distancmeter 250 ml), ***cka nuk ka lidhje me objektin e prokurimit pasi nuk është pajisje informatike, nuk disponohen specifikimet teknike lidhur me distancë metër***, formular I njoftimit të fituesit, garanci, ekstrakt nga QKR, fletë hyrje nr.8, datë 10.10.2016, faturë me TVSH nr.5059, datë 04.10.2016, ftesë për ofertë, veprim I cili bie ndesh me **Ligji nr.10296**, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 2, neni 4, pika 19, pika 26, **UMF nr.30**, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" neni 36Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës...., **Urdhri nr.33**, datë 11.07.2013 "Për Gjurmët Standarte të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë".

Urdhër Shpenzimi nr.142, datë 24.10.2016, shërbime të tjera, në shumën 52,300lekë, për llogari të PC S. sh.p.k. Disponohet faturë me TVSH nr serial 41812908 datë 19.10.2016 (HDD 1TB, Antivirus, USB TP-LINK), urdhër prokurimi nr.11, datë 10.10.2016, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, 3 ofertat, fletë hyrje nr.9, datë 19.10.2016

Urdhër Shpenzimi nr.34, datë 10.03.2017, materiale zyre, në shumën 35,800lekë (likujdim pjesor), për llogari të G. P. E. Disponohet urdhër prokurimi nr.1, datë 06.03.2017, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, 3 ofertat, faturë e thjeshtë tatimore nr.8, datë 09.03.2017, në shumën 129,000lekë, fletë hyrje nr. 1, datë 09.03.2017.

Urdhër Shpenzimi nr.118, datë 24.10.2017, blerje gazi për ngrohje, në shumën 79,986lekë, për llogari të K. sh.p.k dhe urdhër shpenzimi nr.119, datë 24.10.2017, blerje karburanti në shumën 181,034lekë, për llogari të të njëtit OE K. sh.p.k. Disponohet faturë me TVSH nr.76, datë 11.10.2017 në shumën totale 261,014lekë, fletë hyrje nr.11, datë 11.10.2017, ekstrakt nga QKR, raport analizimi me nr.3904/1 prot, datë 12.09.2017.

Urdhër Shpenzimi nr.125, datë 07.11.2017, shërbime të tjera, material të tjera, në shumën 86,850lekë, për llogari të S. C. Disponohet urdhër prokurimi nr.11, datë 01.11.2017, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, 3 ofertat nga OE, faturë e thjeshtë tatimore nr.94, datë 03.11.2017, fletë hyrje nr.12, datë 03.11.2017

Urdhër Shpenzimi nr.126, datë 14.11.2017, likujdim fature shërbime e mirmbajtje zyrash, në shumën, 198,833lekë për llogari të N. D.. Disponohet procesverbal I datës 14.11.2017 I marrjes në dorëzim të punimeve të kryera, faturë me tvsh nr.1, datë 14.11.2017, kontratë e datës 08.11.2017 lidhur midis titullarit të ALUIZNI-t Kukës dhe përfqësuesit të OE fitues, ekstrakt nga QKR, urdhër prokurimi nr.10, datë 20.09.2017, ftesë për ofertë.

Urdhër Shpenzimi nr.9, datë 19.02.2018, shërbime të printimit e publikimit tonera dhe kancelari në shumën totale 139,600lekë, për llogari të G. P. E. Disponohet urdhër prokurimi nr.1, datë 12.02.2018, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000lekë, 3 ofertat nga OE, faturë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

thjeshtë tatimore nr.23, datë 15.02.2018, fletë hyrje nr.2, datë 15.02.2018. Nga auditimi I kryer në regjistrin elektronik të QKR rezultoi se OE G. P. E. me Nipt K87615201H, është I pezulluar që prej datës 29.03.2016

Urdhër Shpenzimi nr.21, datë 17.04.2018, tonera, në shumën 66,480 lekë, për llogari të C. W. Tiranë. Disponohet urdhër prokurimi nr.3, datë 15.03.2018, procesverbal I prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë, 3 ofertat, faturë me TVSH nr.16, datë 20.03.2018, fletë hyrje nr.4, datë 20.03.2018

C. ZBATIMI I PROCEDURAVE LIGJORE NË LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE

Drejtorja Rajonale ALUIZNI-t Qarku Kukës funksionon në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 241, datë 02.10.2014 "Miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe Drejtoritë në varësi të saj, në zbatim e në përputhje me VKM nr. 63, datë 12.02.2014 për ndryshimin e VKM nr. 545, datë 11.08.2011, me një Strukturë; Drejtor, sektori i Legalizimit Planifikimit Urban, sektori i Hartografisë Përpunimit Informacionit, sektori i Çështjeve të Pronësisë dhe sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Për periudhën objekt auditimi ka në organikë; për vitin 2015 gjithsej 12 nëpunës, nga të cilët 8 me kontratë definitive dhe 4 me kontrata provizore; për vitin 2016 me 18 nëpunës, nga të cilët 8 me kontratë definitive dhe 10 me kontratë provizore; për vitin 2017 me 19 nëpunës, nga të cilët 9 me kontratë definitive dhe 10 me kontrata provizore dhe aktualisht me 14 nëpunës, nga të cilët 10 me kontratë definitive dhe 4 me kontratë provizore.

-Krijimi i bazës së të dhënave për ndërtimet pa leje dhe përpunimi i tyre. Evidentimi dhe diferencimi në subjektet përfitues ose jo nga procesi i legalizimit.

I. Në auditimi i ushtruar mbi këtë proces që me krijimin e Agjencisë dhe Drejtorive Rajonale mbështetur në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 (ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.07.2007, ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008, ligjin nr. 10099, datë 19.3.2009, ligjin nr. 10169, datë 22.10.2009, vendimin nr. 3, datë 02.02.2009 të Gjykatës Kushtetuese, ligji nr. 10 219, datë 4.2.2010, ligji nr. 141/2013, datë 2.5.2013, ligji nr. 50/2014, datë 14.5.2014, ligji 62/2015, datë 11.6.2015) "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", rezulton se është krijuar database me rubrikat përkatëse i cili administrohet në këtë drejtori mbështetur në të dhënat kryesisht nga regjistrat e grumbulluar dhe dorëzuar në Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Kukës.

I. Nga viti 2006 deri në 30.04.2017, sipas pasqyrave të paraqitura për objektet informale kërkesat për legalizim (vetëdeklaruar) e objekteve informate pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës janë **4147** procedues, nga e cila; nga viti 2006 deri në 31.12.2012 janë 2199 vetëdeklarime të dhëna të marra nga pushteti vendor; në vitin 2013 janë vet deklaruar 181, në vitin 2014 dhe 2015 janë vetëdeklaruar 1631 vet deklarime dhe në vitin 2016 janë 136 vetëdeklarime.

Aplikimet ne total qarku Kukës	4001	dosje
Aplikime në Bashkinë Kukës	2436	dosje
Aplikime në Bashkinë Tropojë	790	dosje
Aplikime në Bashkinë Has	775	dosje
Nga këto:		
Aplikime në vitin 2006	2017	dosje
Aplikime në vitin 2013	181	dosje
Aplikime në vitet 2014-2015	1659	dosje
Aplikime pas shtatorit 2016	144	dosje



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Në regjistrat elektronike marrë në dorëzim nga pushteti vendor, ka boshllëqe në kolonat përkatëse dhe nuk janë hedhur të dhënat sipas modaliteteve të udhëzimeve, në 50 raste në vetdeklarimet e viteve 2006-2014 si dhe për periudhën 2015-2016, mungojnë të dhënat për adresat e objekteve, në kolonën e NJQV shënohet vetëm njësi.

Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Qarku Kukës, nuk janë verifikuar e plotësuar të dhënat e munguara, nuk janë azhurnuar të dhënat e subjekteve që kanë marrë leje legalizimi për vitin 2009-2014 deri në vitin 2015, nuk janë hedhur të dhënat në database përkatës mbi objektet në tokë shtet dhe pronar dhe të tretë.

Të dhënat e paraqitura në database e përgjithshëm të vetëdeklarimeve të hedhura nga Nj.Q.V. dhe ALUIZNI, kryesisht mbi funksionin e objektit informal, nuk përputhen me të dhënat e evidentuara në formularin e vetëdeklarimit nga vetë poseduesi i objektit, ku nëse në regjistrat është paraqitur funksioni shërbimi (biznes, magazina, hotele etj.), sipas formularit të vetëdeklarimit, në formularin vetëdeklarimit depozituar në dosje evidentohet se objektet janë ose më funksion të kombinuar ose banimi, nuk kanë adresë të sakta të hedhura në database elektronik.

Regjistrat e administruar nuk janë sipas manualit të urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, pasi nuk janë hedhur të dhënat specifike të zonës ku i përket vija e verdhë ose jashtë vijës verdhë, planet rregulluese, datat e miratimit nga KRTSH, kufijtë ndarës, nomenklatura, zona kadastrale, sipërfaqja deklaruar, etj., veprime në kundërshtim me VKM nr. 437 datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin e administrimit të të dhënave për ndërtimet pa leje për ngritjen e bazës të të dhënave", dhe udhëzimin nr. 767 datë 10.09.2014, si dhe udhëzimi nr. 7 datë 08.11.2006 pika (e) ku shprehimisht thuhet "Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t krijon sistemin e saj të përpunimit dhe administrimit të të dhënave, që do të shërbejë për legalizimin e objekteve pa leje dhe për regjistrimin fillestar, si dhe për ecurinë e të gjitha etapave të procesit".

Në vetëdeklarimet e administruar nga kjo Drejtoria Rajonale janë pajisur me leje legalizimi nga viti 2010 deri në 01.03.2017 gjithsej **1403** objekte informale, ose **34 %** e kërkesave. Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2015 deri në 30.04.2018 janë pajisur me leje legalizimi **1006 objekte** ose 25 % e totalit të vetëdeklarimeve.

Për të parë ritmin e lejeve të legalizimit sipas viteve konstatojmë se nga viti 2009 deri në vitin 2014 janë dhënë 397 leje legalizimi ose 10 % të totalit ndërsa, për vitin 2015 janë dhënë 214 leje legalizimi ose 5.2 % të totalit të vetdeklaruar, në vitin 2016 janë dhënë 380 leje legalizimi ose 9.2 %; në vitin 2017 janë dhënë 296 leje legalizimi ose 7.1 %, pra me një mesatare vjetore rreth 8 % në vit leje legalizimi nga totali i vetëdeklarimeve.

Nr	Viti	Leje legalizimi
1	2009-2012	177
2	2012-2014	220
3	2015	214
4	2016	380
5	2017	296
6	deri në 30.04.2018	116
		1403

Të dhënat e mësipërme tregojnë se procesi i legalizimit ka ecur me ritmet jo të kërkuara, duke paraqitur një performancë të ulët në legalizimin e objekteve informale, megjithëse vazhdimisht është kërkuar që ky proces të përfundojë në një periudhë sa më të shpejtë, për të hapur rrugë procesit të urbanizimit të zonave informale.

Duhet theksuar se ndryshimet e shpeshta të akteve ligjore e nënligjore të procesit të legalizimit të objekteve informale nuk ka kanë rritur sasinë e objekteve informale për të pajisur me leje legalizimi, megjithëse nga Drejtoria e Përgjithshme ALUIZNI-t Tirane janë urdhëruar: sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

shkresës me nr. 6125, datë 10.09.2015 që të legalizohen 20 objekte në muaj, pra duhet të pajiseshin në vitin 2015 gjithsej sipas planit 240 objekte në fakt janë legalizuar vetëm 214 objekte, ose 98 % e planifikimit; sipas shkresës me nr. 4382 prot. datë 19.05.2016, Planifikon që të legalizohen 40 objekte në muaj, pra duhet të pajiseshin në vitin 2016 gjithsej sipas planit 480 objekte ne fakt janë legalizuar 380 objekte, ose 79 % e planit; sipas shkresës me nr. 1149 prot. datë 13.02.2018, për vitin 2017 dhe 2018 planifikon që të legalizohen 40 objekte në muaj, pra duhet të pajiseshin në vitin 2017 gjithsej sipas planit 480 objekte ne fakt janë legalizuar 296 objekte, ose 62 % e planit. Pra me një performancë jo të plotë.

II. Sipas te dhënave të disponuara në Drejtorinë Rajonale konstatohet se nga **4001** objekte të vetëdeklaruar në total për periudhën objekt auditimi nga viti 2015 deri ne 30.04.2018 janë nxjerrë nga arshiva për punim e përditësim 2051 dosje objektesh ose 51 % e totalit, nga të cilat; **1368 dosje objektesh janë** raportuar në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t me procedura terreni dhe dokumentare të përfunduara, (pasi janë kryer matjet, genplanet, planimetri, është tërhequr informacion nga ZVRPP, Procesverbalet e Konstatimit, Akt kualifikimit si dhe Vendimet e Kualifikimit) **dhe 585** dosje objektesh janë rikthyer në arshivë, pa u dokumentuar mbi përfundimin apo jo të procedurave të terrenit dhe dokumentare, pa u dokumentuar arsyet e rikthimit ne arshive, dhe pa u selektuar më parë si subjekte që duheshin shkualifikuar apo jo. Veprime në kundërshtim me nenin 38 dhe 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime. Për periudhën nga 01.01.2015 deri në 30.04.2018 në Drejtorinë Rajonale nga 1368 dosje të përfunduara, janë pajisur me leje legalizimi 1006 objekte ose 74 % e dosjeve të përfunduara. Nga dosjet e përfunduara e të pajisur me leje legalizimi, janë 885 objekte ne toke shtet dhe 146 janë në tokë me vet pronar.

Pra konstatohet se nuk kane zbatuar afatet ligjore për përfundimin e këtyre objekteve, dosje të cilat dalin dhe nuk përfundojnë procedurat ligjore. (shif. pasqyrën e mëposhtme).

LISTA E RAPORTIMEVE PERIODIKE MUJORE 2015 - 2018						
Nr.	Muaji Viti	Prot . Nr .	Date	Nr. objekte te perdituesuara	Nr. objekte te perfunduara	Nr. objekte te kthyer ne Arkiv
1	Janar 2015	71	02.02.2015	90	15	35
2	Shkurt 2015	156	04.03.2015	72	30	30
3	Mars 2015	224	03.04.2015	79	28	28
4	Prill 2015	300	05.05.2015	84	17	26
5	Maj 2015	380	02.06.2015	75	19	34
6	Qershor 2015	455	03.07.2015	79	0	38
7	Korrik 2015	517	02.08.2015	75	0	29
8	Gusht 2015	568	02.09.2015	80	8	36
9	Shtator 2015	687	02.10.2015	60	38	5
10	Tetor 2015	807	02.11.2015	41	23	13
11	Nentor 2015	904	02.12.2015	40	24	12
12	Dhjetor 2015	04	08.01.2016	40	47	5
13	Janar 2016	87	02.02.2016	40	35	6
14	Shkurt 2016	200	04.03.2016	40	21	8
15	Mars 2016	292	04.04.2016	40	22	12
16	Prill 2016	389	04.05.2016	40	20	16
17	Maj 2016	509	02.06.2016	40	25	20
18	Qershor 2016	621	01.07.2016	60	39	9
19	Korrik 2016	708	04.08.2016	60	38	25
20	Gusht 2016	768	05.09.2016	60	35	20
21	Shtator 2016	839	03.10.2016	60	45	13
22	Tetor 2016	928	02.11.2016	60	44	12
23	Nentor 2016	1009	05.12.2016	60	47	10
24	Dhjetor 2016	06	05.01.2017	60	69	6
25	Janar 2017	85	02.02.2017	26	33	8
26	Shkurt 2017	229	02.03.2017	60	76	12



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

27	Mars 2017	393	03.04.2017	60	64	9
28	Prill 2017	527/2	03.05.2017	50	56	13
29	Maj 2017	744/1	01.06.2017	60	119	3
30	Qershor 2017	893	03.07.2017	60	13	26
31	Korrik 2017	1050	02.08.2017	54	45	10
32	Gusht 2017	1210	04.09.2017	46	38	16
33	Shtator 2017	1365	04.10.2017	32	42	4
34	Tetor 2017	1554	02.11.2017	45	32	9
35	Nentor 2017	1687	06.12.2017	33	12	11
36	Dhjetor 2017	1786	03.01.2018	15	14	3
37	Janar 2018	14	08.01.2018	0	27	2
38	Shkurt 2018	351	05.03.2018	11	42	2
39	Mars 2018	449	03.04.2018	37	29	4
40	Prill 2018	636	02.05.2018	27	37	5
Totali				2051	1368	585

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të kthyer në arshivë për të cilat: nuk janë dokumentuar arsyet e kthimit të tyre në arshivë, nuk janë njoftuar proceduesit e objekteve, nuk janë ndjekur procedurat ligjore, nuk janë të raportuara dhe nuk janë hedhur në sistemin elektronik, pas verifikimit dhe kualifikimit të tyre.

III. Nga auditimi mbi kualifikimin/shkualifikimin e subjekteve të ndërtimeve informale nga shqyrtimi paraprak i dosjeve sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale u konstatua se për periudhën objekt auditimi se janë listuar për tu shkualifikuar 127 ndërtime informale si në pasqyrën bashkëlidhur. Nga totali prej 127 objekte informate të shkualifikuara; 11 subjekte që kanë ndërtuar objekte informate janë deklaruar të tërhequr nga procesi i legalizimit; 5 subjekte kanë ndërtuar objekte në pronë shtetërore ose mbi objekte publike; 17 subjekte kanë ndërtuar pa respektuar distancat nga rruga e trotuari, çënojnë hyrjen në objekte publike dhe çënojnë trungun e rrugës; ndërsa 94 subjekte nuk kanë objekte të ndërtuar, janë ndërtuar me objekte të pa qëndrueshëm si dhe janë objekte të përfituar nga privatizimi.

Për 127 subjekte me ndërtime informale nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës është vepruar në kundërshtim me neni 38 “ Dhënia e lejës së legalizimit” dhe nenin 39, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 me ndryshime.

I. Sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës (sektori i financës), të ardhurat për vitin 2015 janë në vlerën 24,283 mijë lekë dhe në vlerën 33,775 mijë bono privatizimi për 214 objekte të legalizuara, mesatarisht 113 mijë lekë për një objekt të legalizuar, në vitin 2016 në vlerën 14,124 mijë lekë dhe në vlerën 19,697 mijë bono privatizimi, për 380 objekte të legalizuara mesatarisht 37 mijë lekë për një objekt të legalizuar, në vitin 2017 në vlerën 6,608 mijë lekë dhe në vlerën 9,122 mijë bono privatizimi për 296 objekte të legalizuara, mesatarisht 22 mijë lekë për një objekt të legalizuar.

VITI	Te ardhurat totale	
	LEKE	BONO
2015	24,283,781	33,775,000
2016	14,124,629	19,697,000
2017	6,608,250	9,122,000

Derdhjet në buxhet të të ardhurave të siguruara nga ardhurat e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore janë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

VITI	Te ardhurat totale	Të ardhurat derdhur në buxhet	Të derdhura në Bankë
	Lekë	Lekë	Bono
2015	24,283,781	22,063,781	33,775,000
2016	14,124,629	13,324,629	19,697,000
2017	6,608,250	6,608,250	9,122,000

Rënia e të ardhurave nga procesi i legalizimi ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të akteve ligjore e nënligjore që ka pasuar ligji i legalizimit si dhe legalizimet e proceduesve ne pronën e vet.

II. Për 1403 lejë legalizimi të lëshuara nga viti 2009 deri në 01.03.2017 nuk ka të dhëna të regjistruara se në cilët nga këto objekte janë nisur shkresa për kompensim, nuk është mbajtur regjistër ku të ketë të dhëna se cilat prona janë për tu kompensuar, veprime në kundërshtim me nenin 15/1 "Kompensimi i pronave mbi sipërfaqen takuese prone private, që preken nga ndërtimet pa lejë" të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 të ndryshuar me ligjin 50/2014 me ndryshime si dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 kreu i I, pika 6 dhe 7.

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2015 deri në 30.04.2018, nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës janë pajisur me lejë legalizimi **1006 objekte**, por nuk rezulton një regjistër me të dhënat të hedhura mbi kalimet e pronësisë.

Në të dhënat e dorëzuara nga Përgjegjësi i legalizimit rezultojnë deri në momentin e auditimit nga Drejtoria rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës rezultoi se janë pajisur me leje legalizimi objekte informate të ndërtuara në tokë shtet 860 objekte nga 1006 objekte të legalizuara gjithsej që sipas viteve: në vitin 2015 gjithsej 157 leje legalizimi; në vitin 2016 janë pajisur 342 objekte informale me lejë legalizimi dhe në vitin 2017 janë pajisur me lejë legalizimin 260 objekte informale .

Nga të cilat në vitin 2015 për 157 objekte të legalizuara në parcela me pronësi shtet, janë arkëtuar detyrimi për parcelën ndërtimore vetëm në 154 raste, në vitin 2016 për 342 objekte të legalizuara në parcela me pronësi shtet, janë arkëtuar detyrimi për parcelën ndërtimore vetëm në 100 raste, në vitin 2017 për 260 objekte të legalizuara në parcela me pronësi shtet, janë arkëtuar detyrimi për parcelën ndërtimore vetëm në 49 raste. Për këto kalime nuk ka regjistër ku të jenë regjistruar edhe dërgimi i shkresave në Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t Tiranë. Nga lejet e legalizimit të dhëna në Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës rezulton se ne lejet e dhëna me certifikatë pronësie janë si me poshtë.

Nr.	Viti	Lejet e Dhëna	Kalimi i pronësisë		Kontrata	
			Shtet	Dok. Prone	Nr. Kontrate Kalimi	Pagese (Pas heqjes se Kontratave)
1	2015	214	157	57	154	0
2	2016	380	342	38	43	57
3	2017	296	260	36	0	49
4	30.04.2018	116	101	15	0	34
		1006	860	146	197	140

Pra rezulton se nuk janë ndjekur dhe mbajtur në mënyrë periodike objektet që përfshihen në kompensim për masën e vlerës. Nuk janë hedhur të dhënat specifike të zonës ku i përket vija e verdhë ose jashtë vijës verdhë, planet rregulluese, datat e miratimit nga KRTSH, kufijtë ndarës, nomenklatura, zona kadastrale, sipërfaqja deklaruar, etj. Nuk ka regjistër në përputhje e me manualin në zbatim të Urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 437 datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e procedurave për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

mbledhjen, përpunimin e administrimit të dhënave për ndërtimet pa leje për ngritjen e bazës të dhënave”, dhe udhëzimin nr. 767 datë 10.09.2014, si dhe udhëzimi nr. 7 datë 08.11.2006 pika (e) ku shprehimisht përcaktohet: - “Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t krijon sistemin e saj të përpunimit dhe administrimit të dhënave, që do të shërbejë për legalizimin e objekteve

Nga **1006 objekte informale** të pajisura me leje legalizimi në Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës në periudhën 01.01.2015 deri në 30.04.2018, deri në momentin e auditimit janë miratuar me VKM kalimi i pronësisë, janë lidhur kontratat dhe janë likuiduar detyrimet për parcelat ndërtimore vetëm nga 337, ndërsa për 523 objekte të pajisura me leje legalizimi nuk janë miratuar me VKM kalimi i pronësisë, nuk janë lidhur kontratat dhe nuk janë likuiduar detyrimet për parcelat ndërtimore duke zgatur procesin e legalizimit dhe krijuar mungese të ardhurave në buxhetin e shtetit për periudhën 01.01.2015 deri 30.04.2018 në shumën prej **84,987,500 lekë** (e marrë “mesatarisht” 250 m² për një objekt në vlerën prej 650 lekë/m² (523 objekte x 250 m² për objekt x 650 lekë/m²). Veprime këto jo në përshtatshmëri me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 17 pika 5, ku përcaktohet:

“Vlera e parcelës ndërtimore që i shitet poseduesit të ndërtimit pa leje paguhet menjëherë në momentin e njoftimit me shkrim nga ALUIZNI, duke përfutur reduktim të vlerës”.

Zgjatje të procedurave dhe mos paraqitja e qytetarëve për të likuiduar detyrimin e parcelave ndërtimore, e cila do ketë efekte negative në të ardhurat në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës, në të gjitha rastet e dërgimit në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, të të dhënave për parcelat ndërtimore të legalizuara për t’u miratuar kalimi i pronësisë, nuk janë shkelur afatet e dërgimit por përpunimi i të dhënave deri në daljen e VKM për kalimin e pronësisë i kalon afatet e përcaktuara në urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t me nr. 546 date 20.01.2016 dhe me nr. 37 datë 19.01.2016, si dhe në kundërshtim me Pikat 6 dhe 7 të “Matricës së procedurave dhe afateve për shqyrtimin administrativ për legalizim”

Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës edhe në vazhdimësi gjatë vitit 2018 janë lëshuar leje legalizimi vetëm për objektin duke mos likuiduar më parë parcelat ndërtimore, duke zgatur këtë proces, me muaj e vite dhe duke shkelur afatet ligjore të ligjit nr. 9482 në neni 28 “Dhënia e lejes së legalizimit” ku përcaktohet:

Zyra përkatëse e ALUIZNI-t, me plotësimin e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në nenin 27 të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga përfundimi i procedurave administrative pajis subjektin me lejen e legalizimit. I njëjti rregullim, por me ndryshime specifike, të përcaktuara në këtë ligj, zbatohet edhe për "shtesat pa leje në ndërtime me leje".

Kriteret, procedurat dhe formulari i lejes së legalizimit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.....

Për sa më sipër konstatojmë se: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t qarku Kukës ka pajisur me leje legalizimi **523 objekte informale**, pa u likuiduar me parë parcelat ndërtimore dhe në lejet e legalizimit të lëshuara është vendosur nënshkrimin “Do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”, duke vepruar në përputhje e zbatim të VKM-së nr. 954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”.

Aktet nënligjore të cituara me lart bien në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 01.04.2015 i ndryshuar pika 8 ku përcaktohet:

“Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”). Për kryerjen e këtyre procedurave drejtoritë mbështeten në cilësitë e territorit, të paraqitura grafiki.....”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Si dhe me ligjin 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime në ligjin nr. 50/2014 dhe në ligjin nr. 62/2015, neni 17 (pika 5) ku shprehimisht përcaktohet se:

"Vlera e parcelës ndërtimore që i shitet proceduesit të ndërtimit pa lejë paguhet menjëherë në momentin e njoftimit me shkrim nga ALUIZNI, duke përfutur reduktim të vlerës....".

Të dhënat janë nga baza e të dhënave Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kukës

III. Në Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kukës në dosjet e audituara të pajisura me leje legalizimi nuk figurojnë vërtetimet e *likuidimit të taksës së infrastrukturës*.

Bazuar në informacioneve shkresore dhe elektronike nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kukës sipas pasqyrave të paraqitura rezultojnë se për periudhën objekt auditimi janë gjithsej 1006 objekte informale të pajisura me leje legalizimi, nga këto rezultojnë:

-Në Bashkinë Kukës janë legalizuar 675 objekte me sipërfaqe totale 139724.97 m², pra për 139724.97 m² me ndërtesë duhej të likuidohet taksa e infrastrukturës në vlerën **22,984,058 lekë** (139724.97 m² x 32,899lekë/m² x 0.5%) .

-Në Bashkinë Tropojë janë legalizuar 101 objekte me sipërfaqe totale 20608.06 m², pra për 20608.06 m² me ndërtesë duhej të likuidohet taksa e infrastrukturës në vlerën **3,389,922 lekë** (20608.06 m² x 32,899lekë/m² x 0.5%) .

-Në Bashkinë Has janë legalizuar 230 objekte me sipërfaqe totale 52566.75 m², pra për 52566.75 m² me ndërtesë duhej të likuidohet taksa e infrastrukturës në vlerën **8,811,462 lekë** (52566.75 m² x 32,899lekë/m² x 0.5%) .

Pra për periudhën 01.01.2015 deri 30.04.2018 në Bashkitë Kukës, Tropojë dhe Has për 1006 objekte të legalizuara duhej të likuidonin taksën e infrastrukturës në vlerën **35,185,442 lekë** për 212900 m² ndërtesa të legalizuara.

Mungesa në dosjet e vetëdeklarimeve të pajisura me leje legalizimi dhe të audituara e vërtetimeve mbi likuidimin e taksës së infrastrukturës janë veprime në kundërshtim me nenet 27 dhe 37 të ligjin 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar, si dhe VKM 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar.

Në procesin e auditimit Njësive të Vetëqeverisjes Vendore u është kërkuar nr. 836 dhe 837 Prot. datë 15.05.2018 niveli i arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale të pajisur me leje legalizimi.

Referuar të dhënat nga Bashkitë e Qarkut Kukës të mara këto të dhëna zyrtarisht, rezulton se nga 01.01.2015 deri në 30.04.2018 kanë likuiduar taksën e ndikimit në infrastrukturë për objektet informale të pajisur me leje legalizimi si me poshtë:

- ne Bashkinë Kukës referuar shkresës nr. 2292/1, datë 24.05.2018 kanë likuiduar taksën e ndikimit në infrastrukturës vetëm **93** objekte në vlerën totale **2,525,382 lekë**.

- ne Bashkinë Tropojë referuar shkresës nr. 2194/1, datë 21.05.2018 kanë likuiduar taksën e ndikimit në infrastrukturës vetëm **28** objekte në vlerën totale **929,084 lekë**.

- ne Bashkinë Has referuar shkresës nr. 952, datë 16.05.2018 kanë likuiduar taksën e ndikimit në infrastrukturës vetëm **62** objekte në vlerën totale **1,811,084 lekë**.

Pra në total kanë likuiduar taksën e infrastrukturës në Bashkitë Kukës, Tropojë dhe Has gjithsej 183 objekte (93+28+62) ose 18 % e totalit të objekteve të pajisura me leje legalizimi në vlerën totale **5,265,550 lekë** (2,525,382 + 929,084 + 1,811,084) ose nga vlera **35,185,442 lekë**, kanë likuiduar taksën e infrastrukturës në masën 15 %.

Mos arkëtimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë krijuar nga legalizimi i ndërtimeve informale ka ardhur edhe nga mos bashkëpunim në nivelin e duhur me Drejtoritë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe mos dërgim në kohë i informacioneve për të gjithë objekteve të legalizuara.

Për periudhën objekt auditimi nga Bashkitë Kukës, Tropojë dhe Has për 1006 objekte të legalizuara duhej të arkëtohej taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **35,185,442 lekë** për 212900 m² ndërtesa të legalizuara, në fakt rezulton të jenë likuiduar vetëm 5,265,550 leke ose 15 % vlerës së llogaritur. Me një diferencë të pa likuiduar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

duke krijuar tëardhura të munguar për periudhën 01.01.2015 deri në 31.12.2017 **në vlerën prej 29,919,892 lekë** (35,185,442 lekë – 5,265,550 lekë të likuiduara) të objekteve të legalizimit të shpërndara proceduesve të objekteve informale nuk kanë likuiduar taksën e ndikimit në infrastrukturë

Pra sa me sipër me veprime e mos veprime bien në kundërshtim me ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar neni 3 pikat "gj" dhe "i", neni 23, si dhe neni 27 "Dokumentacioni tekniko- ligjor për legalizimin e objektit" pika (ç) ku përcaktohet se:

"Vërtetim për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi",

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 860, datë 10.12.2014 pika "5", ku përcaktohet:

Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi.

Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (vënë në dispozicion nga drejtoria e ALUIZNI-t, Durrës), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m² (brenda/jashtë vijës së verdhë), për efekt pagese të vlerës së truallit, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, e cila është pjese përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultonin në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore.

Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna, jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t'i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprime të cilat janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen-plan, planimetri)", i ndryshuar, si dhe shkronja "f" dhe "g" e neni 3 dhe pika 1 e neni 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim edhe VKM^{-së} nr. 1620 datë 26.11.2008, **në 57 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore brenda/jashtë vijës së verdhë **pa legalizuar prej 13582.46 m²** (në total), **me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 18,212,490 lekë**, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve.

Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës jo vetëm që nuk janë mbajtur evidenca mbi përfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, por nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar dhe bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkitë Kukës e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Has, vënien në dispozicion të listës së sipërfaqeve të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet, apo vlerësimin e tyre si troje që përdoren nga qytetarët, pa u taksuar ose për kthim në ambiente publike çlodhëse, lulishte. Gjithashtu në asnjë prej dosjeve të legalizimit nuk ndodhet asnjë deklaratë noteriale nga individët të cilat pranojnë ose refuzojnë të blejnë truallin sipas çmimit të tregut për pjesën e parcelës të zaptuar e cila është mbi normën ligjore.

Mbi marrëdhëniet me ZVRPP Kukës, Tropojë e Has Në përputhje me fazat e procedurës së legalizimit të përcaktuara në Ligjin nr. 9482/2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, Sektori i Hartografisë, Përpunimit të Informacionit dhe Çështjeve të Pronësisë, mban rast pas rasti korrespondencat me ZVRPP-në, për praktikat e legalizimit të marra në shqyrtim.

Një nga llojet e korrespondencave drejtuar ZVRPP-së, është kërkesa për status juridik të parcelave ndërtimore të zëna nga shtesat informale. Sektori i Hartografisë, pasi bëhet verifikimi në terren dhe azhurnimi në HTR, përpilohet kërkesa për statusin juridik drejtuar ZVRPP. Shkresës përcjellëse i bashkëlidhet harta e azhurnimit të objektit informal me të dhënat e nevojshme.

Nga auditimi u konstatua se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës nuk janë respektuar afatet ligjore për dërgimin e dokumentacionit të lejes së legalizimit në ZVRPP Tropojë në kundërshtim me pikën 10 të Vendimit nr. 1095 date 28.12.2015 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara" ku përcaktohet se "Kërkesa për regjistrim paraqitet në ZVRPP nga ALUIZNI, brenda 5 ditëve nga data e miratimit të lejes së legalizimit..."

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës disponon një regjistër të veçantë për shkresat e dërguara në ZVRPP Has, Tropojë e Kukës në të cilin evidentohen sipas datave përkatëse dhe objektit të shkresës.

Kërkesat janë bërë në përgjithësi të grupuara si për objektet që disponojnë dokumente pronësie dhe për ndërtimet informale që nuk disponojnë dokument pronësie.

Me anë të hartës së përditësuar vektoriale kërkohet njëkohësisht statusi juridik dhe për objektet që nuk disponojnë dokument pronësie. Sipas hartës vektoriale që dërgohet në ZVRPP evindentohet objekti se bashku me truallin funksional të objektit. Në këto kushte ZVRPP brenda një afati 15 ditor duhet të përgjigjet me shkresë zyrtare mbi të dhënat juridike dhe hartat kadastrale që ato disponojnë. Ndërkohë që me miratimin e VKM nr. 1095 datë 28.12.15 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara", edhe në rast të mos përgjigjes zyrtare nga ZVRPP, ALUIZNI vazhdon procedurat e legalizimit. Nga përgjigjet e ardhura ka rezultuar se në rastet me ZVRPP Tropojë përgjigjet kanë qenë përtej afatit 15 ditor të lejuara nga ligji, në disa raste sporadike përgjigjet janë kthyer mbas disa muajsh, si rezultat i vonësive postare dhe/ose diktuar nga vonesat procedurale të mbajtura nga ZVRPP Tropojë. Në disa raste janë pasqyruar dhe mangësi dhe pasaktësi në përgjigjet e marrasi p.sh: mosdhënie informacioni për ndonjë pasuri të ndodhur në hartë, informacion i gabuar, mungesë të informacionit të plotë dhe të detajuar, etj.

Në bazë të të dhënave të paraqitura, rezulton se në total për periudhën kohore nga 01.01.2015-30.04.2018, janë përgatitur 596 shkresa me kërkesa për status juridik për 3397 parcela nga të cilat nga ZVRPP përkatëse Has Tropojë dhe Kukës janë kthyer përgjigje me 594 shkresa për 3351 parcela. Shkresa të pakonfirmuara janë nga ZVRPP Tropojë, me nr. 293 prot datë 23.02.2018 dhe nr. 459/2 prot date 27.04.2018, përkatësisht sipas periudhave dhe ZVRPP-ve si më poshtë:

ZVRPP Tropojë: Afatet e kthimit të përgjigjeve për statuset juridike janë mbi 30 dite nga data e shkresës të dërguar. Konkretisht shkresa me nr. 1731 prot datë 15.12.2017 ka kthim përgjigje



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

me nr. 52 prot datë 27.01.2018; shkresa me nr. 420 prot datë 11.05.2016 ka kthim përgjigje me nr. 1764 prot datë 13.06.2016.

ZVRPP Has: Afatet e kthimit te përgjigjeve për statuset juridike në përgjithësi janë brenda afateve ligjore prej 15 dite kalendarike. Disa zona kadastrale nuk kane harta dixhitale pasi nuk janë futur ne sistem dhe nuk kane informacion për pasuritë mbi te cilat ndodhen objektet informale.

ZVRPP Kukës: Afatet e kthimit te përgjigjeve për statuset juridike janë brenda afateve ligjore prej 15 dite kalendarike. Disa zona kadastrale nuk kane harta dixhitale pasi nuk janë futur ne sistem dhe nuk kane informacion për pasuritë mbi te cilat ndodhen objektet informale. Hartat manuale te ZVRPP Kukës, konkretisht harta e zonës kadastrale nr. 2762 "Nangë" është tepër e pasakte, ka mospërputhje te mëdha midis formës dhe madhësisë se parcelës me atë qe është ne fakt.

Një problematikë tjetër e hasur gjatë korrespondencës me ZVRPP është dhe mos vënia në dispozicion nga ZVRPP Has dhe Kukës e hartave digjitale me ndryshimet e përditësuar sipas hartave manuale që disponon ZVRPP.

Si përfundim nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës, duhet të merren masa për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme për shkresat në lidhje me statuset juridike të pasurive, respektimin e afateve të trajtimit të tyre, përgjigjet e dhëna nga ZVRPP si dhe problematikat e hasura në vazhdimësi, duke i shërbyer në këtë mënyrë mbarëvajtjes së procesit të legalizimit.

Gjithashtu Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës duhet të marrë masa e të bashkërendojë punën me ZVRPP Has e Kukës në lidhje me përditësimin e hartave dixhitale sipas hartave manuale që disponon ZVRPP.

-Auditim mbi besueshmërinë ligjore të shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave dhe respektimi i afateve ligjor për kthim përgjigje.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës është administruar dhe mbajtur një regjistër i veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve ndër vite për periudhën 01.01.2015-30.04.2018, në të cilin janë trajtuar ankesat e bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit të tyre si dhe zgjidhjen e problemit.

Gjatë periudhës së auditimit ankesat janë administruar dhe trajtuar nga A. G. me detyrë Specialiste e Sektorit të Legalizimit.

Në thelb të ankesave të qytetarëve qëndrojnë pretendimet për mos legalizimin e objekteve që ndodhen në pronën e të ankimuarve apo personave të tyre të afërm. Në mbështetje të Ligjit 9482 dt. 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar Neni 15/1 pika 1,

"Kur parcela ndërtimore e objektit pa leje është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në emër të subjekteve pronarë jo posedues të ndërtimit, masa dhe vlera e kompensimit mbi sipërfaqet takuese pronë private që preken nga objekti miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave."

Ankesat konsistojnë edhe në pretendimet e qytetarëve "përjashtim" në fqinjësi për mos legalizimin e objekteve/shtesave informale të subjekteve aplikuese, përjashtim nga procedurat për legalizim të objekteve të cilat kanë zaptuar pronën publike dhe hapësirën e përbashkët, kërkesë për legalizim të parcelës pa objekt informal, verifikim në terren të ndërtimeve, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës gjatë periudhës 01.01.2015 – 30.04.2018 ka administruar 27 kërkesë/ankesa nga qytetarët

- 5 (pesë) prej tyre janë për rishikimin të aktit administrativ "përjashtim" nga procesi i legalizimit jashtë afateve ku ankimuesi nuk i është drejtuar gjykatës por kanë bërë kërkesë pranë Drejtorisë Rajonale dhe në një rast në Drejtorinë e Përgjithshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

- 4 (katër) prej tyre mbi mos respektimin e afateve në procesit e legalizimit ku në një rast (parcela ndërtimore në tokë të njësisë të qeverisë vendore) në kundërshtim me nenin 15/1 pika 2 të ligjit 9482 datë 3.4.2006, “ për legalizimi...” I ndryshuar.
- 8 (tetë) prej kërkesë/ankesave janë mbi objektet informale kufitare ose me mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve.
- në 1 rast prej kërkesë/ankesave të administruar mbi funksionin e ndërtimit informal përcaktuar bazuar në evidentimin në terren si dhe deklaratën personale të plotësuar nga ana e vetë deklartuesit.
- në 1 rast prej kërkesë/ankesave është për përfshirjen në legalizim të një parcelë ndërtimore më shumë se përcaktimet ligjore dhe pa respektuar distancat nga objekti kufitar.
- në 2 raste prej kërkesë/ankesave të administruar me nr. 812prot, datë: 26.09.2016 dhe nr. 812/1 prot, datë 31.10.2016 është kërkuar regjistrimi i lejes së legalizimit (për pjesën ku ka mbivendosje).
- në 1 rast prej kërkesë/ankesave të administruar me nr. 649 prot, datë: 22.08.2015 është për përfshirje në bashkëpronësi.
- në 3 raste prej kërkesë/ankesave të administruar është për të drejtën e informimit.
- në 1 rast prej kërkesë/ankesave të administruar me nr. 1045 prot, datë: 14.12.2016 është për legalizimin e parcelës pa ndërtim informal.
- në 1 rast prej kërkesë/ankesave të administruar me nr. 758 prot, datë: 02.09.2016 është për ndryshimin e planimetrisë së objektit të regjistruar.

Nga dokumentacioni i administruar dhe të dhënat e paraqitura në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës, në kërkesat e bëra nga qytetarët për legalizimin e objekteve informale apo institucione të ndryshme, konstatohet se për periudhën objekt auditimi nga 27 ankesa në total, në 2 raste nuk ka përgjigje pasi ankesat janë për Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoria Rajonale Kukës është vetëm për dijeni, ankesat janë marrë në shqyrtim dhe kthyer përgjigje brenda afateve ligjore, që do të thotë se përgjigja dhe reagimi ndaj ankesave të qytetarëve ka qenë korrekt.

Theksojmë se përveç përgjigjeve të kthyer zyrtarisht brenda afateve ligjore është e domosdoshme bashkëpunimi dhe rakordimi ndërmjet sektorëve, dhe me juristin e institucionit, bashkëpunim i cili realisht mungon, për dhënien e zgjidhjeve ligjore dhe kthimit të përgjigjeve në kohë të ankesave të qytetarëve për problemet në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 9482 dt. 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizmin, integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Kodit të Procedurës Administrative, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Trajtimet të ankesave të qytetarëve, kthimi i përgjigjeve zyrtare ka trajtuar problemin brenda kompetencave të përcaktuara nga ligji të ALUIZN-t duke i adresuar dhe përgjigjur mbi problematikat e ngritura nga ankesat e qytetarëve.

-Procedurat e miratimit dhe dhënies së lejes së legalizimit nga Drejtoria Qendrore dhe Rajonale e Legalizimit (ALUIZNI), shlyerja e detyrimeve financiare për legalizim nga subjektet vetëdeklarues dhe regjistrimi në ZVRPP. Auditimi i mënyrës së llogaritjeve dhe dokumentimit të vlerave të legalizimit sipas kategorive përkatëse për tu arkëtuar nga subjektet vetëdeklarues, që kanë paraqitur kërkesë për legalizim.

Sipas dosjeve të audituar dhe informacioneve të mara elektronikisht, ka rezultuar se nuk shënohen data e marrjes së dosjes për përpunim dhe dorëzimi i dosjes nga inspektorët e terreni, hartografisë, vlerësimit, sektori juridik dhe e vlerësimit përfundimtar, nuk janë shënuar të gjitha të dhënat në proces verbalet e konstatimi dhe verifikimit me të gjitha modalitetet përkatëse kryesisht distancat nga rrugët, vetëm nr. e pasurisë të cilët kufizohet prona, në objektet e ndërtuar në tokë “Arë” etj., në dosje nuk ka dokument argumentues ligjor të këtyre parcelave të aprovuar në truall, pra veprime këto në kundërshtim me nenin 10, 11, 27, 39, 40 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime si dhe ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 i ndryshuar, si dhe VKM 438 datë 28.06.2006 ndryshuar me VKM nr. 994 datë 06.10.2010, me ndryshime si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 kreu i II si dhe Udhëzimi nr. 1451, datë 1451, datë 07.10.2015 kreu i II pika 13, 14, 15 dhe konkretisht:

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

- Dosje nr. 1257, datë 29.01.2015

Subjektit S. A. D. i është lëshuar Leje Legalizimi nr. 819, datë 10.04.2017 (me nr. e kuq të serisë 0023631), objekt banimi një kat, me sip. 150 m², me adresë Fshati Fajzë, Bashkia Has u konstatua se:

Dokumentacionit që u vunë në dispozicion për auditim i mungojnë inventari i dosjes së legalizimit, veprim në kundërshtim, me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat".

Procesverbal i matjeve në terren është nënshkruar nga specialistët në terren ing. Sh. M., B. M., dhe miratuar nga përgjegjësi i sektorit të hartografisë B. Z..

- Dosja nr. 720 dt. 16.01.2015

Subjektit I. A.K., i është lëshuar Leja e Legalizimit nr. 55493 dt. 19.04.2017, godinë banimi 2 kat + papafingo me sip. Totale ndërtimi 268 m², adresa: Letaj, Golaj, Bashkia Has nga auditimi u konstatua se:

- është miratuar sipërfaqen e parcelës ndërtimore, në llojin e pasurisë "Truall" duke ndryshuar zërin kadastral. Ndryshimi i zërit kadastral, regjimin e tokës, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimi të kryer për legalizim në zonat "Territore të tjera", veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, "Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale", si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 5, datë 29.12.2014 "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban". Pika 9 ku përcaktohet: "Konvertimi nga tokë "Arrë" në tokë "Truall" për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi".

- Në dosjet me Leje Legalizimi nr. 55822 datë 19.04.2017 në emër të subjektit S. I. A. nga fshati Liqeni I Kuq, Fajza, Bashkia Has; Dosja subjektit I. I. M. me nr. Leje Legalizimi nr. 95824 dt. 9.04.2017, fshati Krumë, Bashkia Has dhe dosjen me Leje Legalizimi nr. 55862 datë 31.05.2017 në emër të subjektit M. D. M. nga fshati Zahrisht, Krumë, dokumentacionit që u vunë në dispozicion për auditim i mungojnë inventari i dosjes së legalizimit, veprim në kundërshtim, me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat",

- Dosja e H. I. J.,

Leje Legalizimi nr. 55875, dt. 23.05.2017 me adresë fshati Golaj, Njësia Administrative Golaj, Bashkia Has godinë banimi 2 kat, nga auditimi u konstatua se:

"Proces verbal i verifikimit në terren" i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje" mbajtur në datë 20.09.2017, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë, vetëm me nr. pasurie, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i parcelës ndërtimore; largësitë nga pikat ekstreme të parcelës ndërtimore, hyrjen në objekt. Nuk pasqyrohet hyrja në parcele si dhe lidhja e parcelës me ndërtesën. Për sa më sipër, procesverbal i verifikimit në terren, nuk pasqyron të dhëna e kërkuara në pikën "Procedura për hartimin e materialeve grafike", të manualit "Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 "Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet" shfuqizuar me Udhëzimin nr 30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (genplan, planimetri).Përgjegjësi mban E. U., B. M. dhe B. Z.

Në Genplan, datë 11.10.2017, i konfirmuar nga z. B. Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, në rubrikën e tretë në qendër të tij, e paraqet plan vendosjen e parcelës ndërtimore, **por pa hyrje për në parcelë.**

Vendimi nr. 2537, datë 29.09.2017 **"Për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të Bylbyl Iliaz Muja"** është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, nenin 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" – "vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi" si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet

– "c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtim me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se – "Drejtoria e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtim me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit."

- Leja e Legalizimit me nr. 56342, datë 12.10.2017 ka miratuar sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 402.03 m², në llojin e pasurisë "Truall" duke ndryshuar zërin kadastral, pasi nga ZVRPP Kukës për pasurinë 402.03 m² nuk ka regjistrim fillestar. **Ndryshimi i zërit kadastral, regjimin e tokës**, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimi të kryer për legalizim në zonat "Territore të tjera", veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, "Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale".

-dosja nr. 137, datë 31.10.2014;

Sipas vetëdeklarimit datë 31.10.2014, poseduesi i objektit informal deklaroi se ka një zënë sipërfaqe prej 358 m², ku është ndërtuar godinë banimi 2 kat + papafingo+ objekt ndihmës me sipërfaqe bazës 113.14 m², Gjallinë Shtiqën Bashkia Kukës dhe sipas Procesverbalit të verifikimit në terren mbajtur më 09.06.2016 kufizohet: V. 1/20, J. 1/19, P. 1/20, L. 1/20.

Në përgjigjen e dërguar nga ZVRPP Kukës, nr 2362/1, datë 15.06.2016, pasuria ndodhet në ZK 3425 (fshati Shtiqën) nuk është e regjistruar pasi kjo zonë kadastrave nuk është hedhur në sistem dhe pasuria është në statusin "shtet".

Leja e Legalizimit me nr. 85671, datë 28.07.2016. Objekti "Godinë banimi 2 kt + papafingo + objekt ndihmës". Parcela ndërtimore 358 m², sipërfaqja e ndërtimit 113.84 m², titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me VKM.

"Proces verbal i verifikimit në terren" i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje" mbajtur në datë 09.06.2016, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë, vetëm me nr. pasurie, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i parcelës ndërtimore; largësitë nga pikat ekstreme të parcelës ndërtimore, hyrjen në objekt. Nuk pasqyrohet hyrja në parcele si dhe lidhja e parcelës me ndërtesën. Për sa më sipër, procesverbal i verifikimit në terren, nuk pasqyron të dhëna e kërkuara në pikën "Procedura për hartimin e materialeve grafike", të manualit "Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 "Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet" shfuqizuar me Udhëzimin nr 30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (genplan, planimetri).Përgjegjësi mban Sh. M., B. M. dhe B. Z.

Në Genplan, datë 16.06.2016, i konfirmuar nga z. B. Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, në rubrikën e tretë në qendër të tij, e paraqet plan vendosjen e parcelës ndërtimore, **por pa hyrje për në parcelë.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Vendimi nr. 2005, datë 22.06.2016 **“Për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të I. O. M.”** është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi” si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet

–“c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se –“Drejtoria e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit.”

- Leja e Legalizimit me nr. 85671, datë 28.07.2016 ka miratuar sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 358 m², në llojin e pasurisë “Truall” duke ndryshuar zërin kadastral, pasi nga ZVRPP Kukës për pasurinë 358 m² nuk ka regjistrim fillestar . **Ndryshimi i zërit kadastral, regjimin e tokës**, në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t’i dhënë lejen, veprimit të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.

-dosja nr. 1264, datë 29.01.2015;

Sipas vetëdeklarimit datë 29.01.2015, poseduesi i objektit informal deklaroi se ka një zënë sipërfaqe prej 428 m², ku është ndërtuar godinë banimi 2 kat + bodrum me sipërfaqe bazës 142 m², Mujaj Shtiqën Bashkia Kukës dhe sipas Procesverbalit të verifikimit në terren mbajtur më 05.08.2016 kufizohet: V. 3/202, J. 3/202; 3/186, P. 3/202, L. 3/186.

Në përgjigjen e dërguar nga ZVRPP Kukës, nr 3076/1, datë 12.03.2016, pasuria ndodhet në ZK 3425 (fshati Shtiqën) nuk është e regjistruar pasi kjo zonë kadastrave nuk është hedhur në sistem dhe pasuria është në statusin “shtet”.

Leja e Legalizimit me nr. 85223, datë 11.10.2016. Objekti “Godinë banimi 2 kt + bodrum”. Parcela ndërtimore 428 m², sipërfaqja e ndërtimit 142.87 m², titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me VKM.

“Proces verbal i verifikimit në terren” i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje” mbajtur në datë 05.08.2016, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë, vetëm me nr. pasurie, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i parcelës ndërtimore; largësitë nga pikat ekstreme të parcelës ndërtimore, hyrjen në objekt. Nuk pasqyrohet hyrja në parcele si dhe lidhja e parcelës me ndërtesën. Për sa më sipër, procesverbal i verifikimit në terren, nuk pasqyron të dhëna e kërkuara në pikën “Procedura për hartimin e materialeve grafike”, të manualit “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet” shfuqizuar me Udhëzimin nr 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (genplan, planimetri).Përgjegjësi mban Sh. M., B. M. dhe B. Z.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Në Genplan, datë 12.08.2016, i konfirmuar nga z. B. Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, në rubrikën e tretë në qendër të tij, e paraqet plan vendosjen e parcelës ndërtimore, **por pa hyrje për në parcelë.**

Vendimi nr. 2092, datë 19.08.2016 **“Për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të R. F. H.”** është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –*“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”* si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet

–“c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se –“Drejtoria e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit.”

- Leja e Legalizimit me nr. 85223, datë 11.10.2016ka miratuar sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 428 m², në llojin e pasurisë “Truall” duke ndryshuar zërin kadastral, pasi nga ZVRPP Kukës për pasurinë 428 m² nuk ka regjistrim fillestar . **Ndryshimi i zërit kadastral, regjimin e tokës,** në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimit të kryer për legalizim në zonat “Territore të tjera”, veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.

-dosja nr. 20, datë 23.11.2006;

Sipas vetëdeklarimit datë 23.11.2006, poseduesi i objektit informal deklaroi se ka një zënë sipërfaqe prej 500 m², ku është ndërtuar godinë banimi 2 kat + papafingo + bodrum me sipërfaqe bazës 150 m², Kodër Lumë, Shtiqën, Bashkia Kukës dhe sipas Procesverbalit të verifikimit në terren mbajtur më 16.06.2016 kufizohet: V. 2/95, J. 2/95, P. 2/95, L. 2/95.

Në përgjigjen e dërguar nga ZVRPP Kukës, nr 2612/1, datë 28.06.2016, pasuria ndodhet në ZK 3425 (fshati Shtiqën) nuk është e regjistruar pasi kjo zonë kadastrave nuk është hedhur në sistem dhe pasuria është në statusin “shtet”.

Leja e Legalizimit me nr. 85136, datë 11.10.2016. Objekti “Godinë banimi 2 kt + papafingo + bodrum”. Parcela ndërtimore 417 m², sipërfaqja e ndërtimit 139.02 m², titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me VKM.

“Proces verbal i verifikimit në terren” i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje” mbajtur në datë 16.06.2016, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë, vetëm me nr. pasurie, edhe skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i parcelës ndërtimore; largësitë nga pikat ekstreme të parcelës ndërtimore, hyrjen në objekt. Nuk pasqyrohet hyrja në parcele si dhe lidhja e parcelës me ndërtesën. Për sa më sipër, procesverbal i verifikimit në terren, nuk pasqyron të dhëna e kërkuara në pikën “Procedura për hartimin e materialeve grafike”, të manualit “Hartimi dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet” shfuqizuar me Udhëzimin nr 30, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (genplan, planimetri).Përgjegjësi mban Sh. M., B. M. dhe B. Z..

Në Genplan, datë 23.06.2016, i konfirmuar nga z. B. Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, në rubrikën e tretë në qendër të tij, e paraqet plan vendosjen e parcelës ndërtimore, **por pa hyrje për në parcelë.**

Vendimi nr. 2022, datë 28.06.2016 "**Për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të Urim Faik Petku**" është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, nenin 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" –"vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi" si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet

–"c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se –"Drejtoria e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit."

- Leja e Legalizimit me nr. 85136, datë 11.10.2016 ka miratuar sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 417 m², në llojin e pasurisë "Truall" duke ndryshuar zërin kadastral, pasi nga ZVRPP Kukës për pasurinë 417 m² nuk ka regjistrim fillestar . **Ndryshimi i zërit kadastral, regjimin e tokës,** në mungesë të dokumentacionit; kërkesa për miratimin në Këshillin e Qarkut, të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Pra, nuk ka asnjë dokumentacion nga këto organe, për t'i dhënë lejen, veprimit të kryer për legalizim në zonat "Territore të tjera", veprime në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, "Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale".

GJETJET NGA AUDITIMI, IMPAKTI TE PASQYRAT FINANCIARE DHE REKOMANDIMET PËRKATËSE

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës në mbështetje të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe (ISSAI 1700, dhe 4200³) për të cilën do të japim opinion: Audituesit e KLSH-së, nëpërmjet auditimit të realizuar në Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, Raportimit Financiar (kriteret e auditimit financiar) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), ku u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:

³ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”, si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar “Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” -Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –“ c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtim me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive të Qarkut Kukës, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi, duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën **29,919,892 lekë**.

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në subjektin Drejtoria Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës për vitin ushtrimor përfunduar më 31.12.2017 të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se; pozicioni financiar, performanca, ndryshimet në kapital, flukset e mjeteve monetare janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit, SNK dhe SKK të përmirësuar. dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700⁴ shprehim një **opinion të pakualifikuar**.

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës më datën 31 dhjetor 2017 performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar, në Shqipëri.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës nuk ka bërë analizë për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe për vjetërsinë e tyre dhe nuk ka politika të shkruara rreth procedurave për njohjen e provizioneve. Mungesa e analizave të duhura rreth të arkëtueshmeve dhe politikave të duhura rreth procedurave për njohjen e provizioneve, ndikon në besueshmërinë e vlerës së tyre. Gjithashtu për vlerat mbi një vit drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin për këto llogari të arkëtueshme.

1.1. Rekomandimi: Drejtuesit e Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës duhet të sigurojë iniciimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin e tyre, si dhe të propozojë masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

⁴Objekti i auditimit është të formulohet një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

- Nga njësitë Drejtuese të Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Kukës të merren masat për çregjistrimi nga llogaritë e njësisë ekonomike të shumave pa shpresë arkëtimi.

Brenda muajit Janar 2019 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës u konstatua se për kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve, nga komisioni i ngritur në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet, asgjësimi i materialeve nuk është shoqëruar me procesverbal, duke përcaktuar vendin e hedhjes, groposjes apo djegies se materialeve të shoqëruara edhe me fotografi.

2.1. Rekomandimi: Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës të marrë masa për kryerjen inventarizimit fizik të aktiveve në fund të vitit ushtrimor 2018, duke bërë që nga komisioni i ngritur për inventarizimin fizik të aktiveve, asgjësimi i materialeve të shoqërohet me procesverbal, duke përcaktuar vendin e hedhjes, groposjes apo djegies se materialeve të shoqëruara edhe me fotografi.

Brenda muajit Janar 2019

3. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës për provizionet e raportuara në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 244,250 lekë e ndryshuar në vite, në shënimet shpjeguese, nuk është dhënë informacioni në lidhje me përshkrimin e krijimit të tyre në çdo raportim vjetor të pasqyrave, parashikimin e shumës dhe kohës së realizimit, rivlerësimin e efektit të saj financiar në çdo datë të raportimi të pasqyrave, një tregues të pasigurive që lidhen me shumën apo kohën e ndonjë dalje dhe mundësinë e ndonjë rimbursimi.

Në pasqyrat financiare në shënimet shpjeguese të bëra, nuk është deklaruar nëse ka qenë praktikisht e pamundur për të dhënë një ose më shumë prej këtyre informacioneve shpjeguese.

3.1. Rekomandimi: Drejtuesit e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës të marrin masa për rivlerësimin e shumës së provizionit prej 21,000 lekë, mbetur nga llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar, pasi ndër vite nuk ekziston informacion në lidhje me përshkrimin, parashikimin, rivlerësimin e efektit të saj financiar në çdo periudhë raportuese.

Brenda muajit Shtator 2018

4. Gjetje nga auditimi: Sipas pasqyrës së aktiveve të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës, janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimi dhe asgjësimin e tyre nga komisioni i ngritur me urdhrat e drejtuesit të ALUIZNI-t për të tre vitet e audituara "Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin jashtë përdorim" në shumën prej 796,266 lekë, proces i realizuar nga gjatë viteve 2016 për aktivet e vitit 2015 e vitit 2017. Për aktivet e vitit 2016 duhej të ishte reflektuar në aktivet e pasqyrave financiare të viteve përkatëse, pasi ngjarja ka ndodhur para raportimit financiar. Kjo në kundërshtim me SKK 1 e përmirësuar.

4.1. Rekomandimi: Drejtuesit e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës të marrin masa për reflektimin në pasqyrat financiare të periudhës raportuese të vlerës së aktiveve afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre nga komisionet përkatëse si ngjarje të ndodhura para raportimit financiar pasi është një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese. Gjithashtu rregullimi i shumave të njohura në pasqyrat financiare, duhet të shoqërohen me dhënien e informacioneve përkatëse shpjeguese, për ngjarjet rregulluese pas përfundimit të periudhës raportuese.

Brenda muajit Shtator 2018

5. Gjetje nga auditimi: Mbi provizionet:

a. Për vitin 2016 ka vendim të Gjykatës së Rrethit nr.449, datë 07.03.,2012 cila konfirmohet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

nëpërmjet Zyrës së Përmbartimit, se është çështje e humbur. DR ALUIZNI-t Qarku Kukës nuk e ka apeluar këtë vendim, veprim i cili ka sjellë pamundësinë për tu gjykuar në shkallët e tjera të gjyqësorit dhe përbën shkelje të disiplinës buxhetore. Për rrjedhojë nuk ka krijuar provizione për këto çështje gjyqësore, ku në gjykimin tonë shuma e provizionit duhej të ishte në vlerën totale të detyrimit dhe si rrjedhojë rezultati i periudhës ushtrimore dhe kapitalet e veta janë mbivlerësuar për 224,250 lekë, gjithashtu edhe detyrimet janë nënvlerësuar në të njëjtën vlerë.
b. Çështje gjyqësore të hapura në vitet e kaluara me punonjës të larguar, për të cilat konfirmohet se janë çështje të humbura nuk ka krijuar provizione për çështjet gjyqësore. Gjykojmë se shuma e provizionit duhej të ishte në vlerën totale të detyrimit, si rrjedhojë rezultati i periudhës ushtrimore dhe kapitalet e veta janë mbivlerësuar, gjithashtu edhe detyrimet janë nënvlerësuar në të njëjtën vlerë.

Për sa më lart është vepruar në kundërshtim me SKK 6 të përmirësuar.

5.1.Rekomandimi:Drejtuesit e Drejtorisë Rajonale të AUZNI-t Qarku Kukës të njohin provizionet për të gjitha vendimet gjyqësore, si ngjarje detyruese të ndodhur para datës së raportimit, për të cilat është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për ndërmarrjen, pasi nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të AUZNI-t Qarku Kukës në pasqyrat financiare të vitit 2015, 2016, dhe 2017 në ngjarje mbas bilancit nuk është raportuar se *“nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare”*.

Në zbatim të urdhrave *“Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin jashtë përdorim”*, ngjarjet e sistemit të veprimeve kontabile të mësipërme kanë ndodhur pas periudhës raportuese. Drejtoria duhet të rregullonte shumën e mësipërme në pasqyrat e saj financiare, duke përfshirë edhe dhënien e informacioneve përkatëse shpjeguese, për pasqyrimin e ngjarjes rregulluese pas përfundimit të periudhës raportuese.

6.1. Rekomandimi: Gjykojmë se shuma e shpenzimeve të shfrytëzimit për periudhën e audituar, duhej të ishte paraqitur edhe me vlerën faktike të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në vlerën për çdo vit, si rrjedhojë rezultati i periudhës ushtrimore dhe kapitalet e veta janë nënvlerësuar gjithashtu edhe detyrimet janë mbivlerësuar në të njëjtën vlerë. Kjo në kundërshtim me SKK 1 e përmirësuar, pasi është një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese.

Brenda muajit Shtator 2018

7. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale e AUZNI-t Qarku Kukës për aktivet afat gjata (*ndërtesa dhe pajisje*), nuk është realizuar një evidentim i shpenzimeve të mirëmbajtjes, rikonstruksionit, amortizimit që nga momenti i marrjes në dorëzim, regjistrimit të tyre në kontabilitet, pra ato nuk janë të paraqitura me koston historike për llogari të Prefekturës e cila i ka në pronësi. Kosto historike e një aktivi ose detyrimi ka disavantazhin që jo gjithnjë paraqet vlerën e saktë të tyre krahasuar me çmimet e tregut.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e AUZNI-t Qarku Kukës të marrë masa që gjatë planifikimit të shpenzimeve për periudhat e ardhshme të planifikojë një zë për evidentimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes, rikonstruksionit, amortizimit që nga momenti i marrjes në dorëzim, regjistrimit të tyre në kontabilitet. Për këto shpenzime të lidhet marrëveshje për transferimin e shpenzimeve në fund të çdo viti ushtrimor dhe pasqyrimin e tyre të aktivet e Prefekturës.

Brenda muajit Shtator 2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

8. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të AUINZI-t Qarku Kukës, kontrolli i brendshëm në ndërmarrje nuk ka funksionuar i plotë, mungojnë procedurat e shkruara ku të përfshihet tërë veprimtaria e njësive ekonomike, si rrjedhim nuk ka ndihmuar në verifikimin e realizimit të detyrave të njësive ekonomike dhe nuk mund të evidentojë dhe parandalojë parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike.

Në kuadër të funksionimit të kontrollit të brendshëm nga drejtuesit e Institucionit, nuk janë hartuar një tërësi masash, procedurash dhe praktikash që zbatohen me qëllim që të mbrohet pasuria e institucionit. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësive është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

8.1. Rekomandimi:- Drejtuesit e Drejtorisë Rajonale të AUINZI-t Qarku Kukës të marrin masa, në kuadër të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të përcaktojnë detyra lidhur me sistemet e kontabilitetit:

Në rrethanat e kontrollit, duhet të përcaktohen qëndrimet e përgjithshme, faktorët kryesorë që ndikojnë në të si: Struktura organizative dhe mënyra e përcaktimit të autorizimeve dhe përgjegjësi; Sistemi i kontrollit i cili zbatohet nga drejtimi (kontrolli i brendshëm, politika e personelit, ndarja e detyrave).

Në veprimet kontrolluese, duhet të përfshihen kryesisht politikat dhe veprimet që ndërmerren për arritjen e qëllimeve si; raportimin, pasqyrimin dhe harmonizimet; vërtetimin e saktësisë së evidencës kontabël; kontrollin e informatave nga sistemi kompjuterik, programet; analiza e llogarive sintetike dhe pasqyrave financiare; lejimi dhe kontrolli i dokumentacionit; krahasimi i të dhënave vetjake me ato të jashtme; krahasimi i rezultateve të inventarizimit të mjeteve monetare; krahasimi dhe analiza e rezultateve reale financiare.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Kukës, për periudhën objekt auditimi, janë pajisur me leje legalizimit objektet, **pa u likuiduar parcelat ndërtimore për 523 objekte informale**, veprime në zbatim VKM-në nr.954, datë 25.11.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit" i ndryshuar dhe VKM-në nr. 1095, datë 28.12.2015 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara". Për 523 objektet informale të pajisur me leje legalizimi nuk ka përfunduar procesi i legalizimit, nuk kanë dalë VKM-të për të likuiduar detyrimin e parcelave ndërtimore, duke zgjatur procesin e legalizimit jashtë afateve kohore veprime në kundërshtim me nenet 17 (pika 5) dhe 27 të ligjit nr.9482, datë. 03.04.2006 me ndryshime; me pikën 8 të VKM nr.280, datë 01.04.2015; Urdhrin nr.37 datë 19.01.2016 për "Matricën e procedurave dhe afateve kohore për shqyrtimin administrativ për legalizim", pika 6 dhe 7, duke krijuar vonesa në likuidimin e tarifave të parcelave ndërtimore, **për vlerën 84,987,500 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit.

9.1.Rekomandim:Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Kukës të marrë masa në ndjekje të ecurisë së procesit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë për daljen e VKM-së, për kalimin e pronësisë dhe shpronësimin e ish pronarëve mbi mos daljen e VKM për legalizim.

Brenda muajit Tetor 2018

10. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës në marrjen e vendimeve "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal", ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, nenin 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" –**"vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi"**, si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret



procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” -Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –“*c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive të Qarkut Kukës, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi, duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 29,919,892 lekë.*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Kukës për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t’i kërkojë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Qarkut Kukës, vërtetimet mbi llogaritjen e likuidimit e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në **vlerën prej 29,919,892lekë, si dhe të kërkojë në ZVRPP Tropojë, e Kukës, për vendosjen e masës së kufizimit deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

Brenda muajit Shtator 2018

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale si dhe evidentimi i sipërfaqeve të lira në pronësi shtet, rezulton se nga ana e Drejtorisë së ALUIZNI-t Kukës, nuk janë evidentuar dhe janë lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, ku sipas genplaneve, hartës fushore, ortofotos digjitale dhe hartës vektoriale të pronësive paraqitur në autocad (*vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI-t, Kukës*), bie në sy se këto parcela janë zvogëluar me qëllim për të qenë në kufirin deri në 300/500 m²(*brenda/jashtë vijës së verdhë*), për efekt pagese të vlerës së truallit. Megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara, të cilat janë pjesë përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që është numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja bashkë do të rezultojnë në sipërfaqen e vetë deklaruar nga poseduesit e parcelës së zaptuar, gjë e cila duket dhe nga skica fushore. Plan vendosja e ndërtimit dhe parcelës së zaptuar pasqyruar në genplan me sipërfaqe të zvogëluar, duke lejuar sipërfaqe të ndërmjetme, kufizuar nga kufijtë e sipërfaqes së legalizuar dhe krijimin e parcelave të pa legalizuara brenda parcelave të zëna jo funksionale.

Bazuar në metodën e veçimit dhe matjes me autocad dhe shenjave konvencionale të përdorur në genplan, evidentohen sipërfaqe e pa legalizuara që duhet t’i ishin bashkëngjitur sipërfaqes së legalizuar, pasi nga pamjet me ortofoto janë lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që ndodhet, veprime të cilat janë në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (*gen-plan, planimetri*)”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim edhe VKM⁵⁶ nr. 1620 datë 26.11.2008, **në 57 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhëe pa legalizuar prej 13582.46 m²(në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 18,212,490 lekë*, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve.

1.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kukës të marrë masa, për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet, lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, të njoftojë me shkresë institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkitë Kukës, Has e Tropojë, duke vënë në dispozicion listën me sipërfaqe të lira, konkretisht në **57 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore *brenda/jashtë vijës së verdhëe pa*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT "MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIETË VEPRIMTARISË SË D.R.ALUIZNI QARKU

legalizuar prej 13582.46 m²(në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së trullit me çmim tregu referuar zonave kadastrale llogaritet në shumën totale prej 18,212,490 lekë (sipas Tabelës "Sipërfaqe të zaptuara pjesë të parcelave ndërtimore të legalizuara", bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky "Raport Përfundimtar Auditimi".

KOTROLI I LARTË I SHTETIT